



Qeveria shqiptare aktivizon rezervistët, ministri Vengu: Forcim i kapaciteteve ushtarake në kohë paqeje



» faqe 3



GJENERALLEJTËNANT KINGJI NË KONFERENCËN E BCHODs: BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE TEKNOLOGJITË E REJA, ÇELËSI PËR SIGURI DHE PAQE NË BALLKAN

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHODs), që u zhvillua në Stamboll, Turqi. Në fokus të kësaj konference ishte vizioni i përdorimit të mjeteve pa pilot në mjedisin operacional, ku SHSHP të Ballkanit trajtuan zhvillimin...

» faqe 3



“HEROI IM NËN UNIFORMË” - NJË BISEDË ZEMRE ME MAJOR GENTI BAJLAS DHE BIJËN E TIJ, ALAJA 8-VJEÇARE

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, Forcat e Armatosura nuk janë vetëm në stërvitje, gatishmëri apo patrullim. Ato janë gjithashtu në zemrën e çdo familjeje që i përket kësaj trupe. Çdo ushtarak/e që kthehet në shtëpi e gjen paqen te zëri i një fëmije, dhe çdo fëmijë që e di që prindi i tij...

» faqe 6



UNIFORMA DHE FOLKLORI, BASHKË NË SHËRBIM TË IDENTITETIT KOMBËTAR

Në ambientet e kinemasë së Garnizonit “Skënderbej”, u zhvillua një aktivitet kulturor me karakter festiv, ku studentët e kësaj akademie performuan një program të pasur artistik me këngë dhe valle tradicionale shqiptare, duke përcjellë vlera të çmuara të trashëgimisë sonë kulturore. Ky aktivitet kishte për qëllim nxitjen dhe ruajtjen e identitetit kombëtar...

» faqe 2

Gjenerallejtënant Kingji në Konferencën e BCHODs: Bashkëpunimi Rajonal dhe Teknologjitë e reja, çelësi për siguri dhe paqe në Ballkan

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit (BCHODs), që u zhvillua në Stamboll, Turqi. Në fokus të kësaj konference ishte vizioni i përdorimit të mjeteve pa pilot në mjedisin operacional, ku SHSHP të Ballkanit trajtuan zhvillimin e shpejtë teknologjik të mjeteve pa pilot, tashmë një komponent kritik i taktikave moderne të luftimit.

Gjithashtu, gjatë punimeve të kësaj konference, u vu theksi edhe në rëndësinë e dimensionit njerëzor, për garantimin e përdorimit të përgjegjshëm të këtyre sistemeve.

Në fjalën e tij në këtë konferencë, SHSHPFA gjenerallejtënant Arben Kingji ndër të tjera theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet vendeve aleate dhe ato partnere për zhvillimin e kapaciteteve, për adresimin e sfidave dhe mundësive që vijnë nga përdorimi i mjeteve pa pilot, si dhe e vlerësoi si shumë të rëndësishme edhe iniciativën e Turqisë për ngritjen e Qendrës së Ekselencës kundër Sistemeve pa pilot.

Më tej, gjenerallejtënant Arben Kingji u ndal edhe në rolin e Qendrës së Inovacionit për Sigurinë dhe Mbrojtjen dhe rivitalizimin e industrisë ushtarake, si pjesë e strategjisë së FARSH-ve për rritjen e kapaciteteve të Mbrojtjes, si dhe në aftësimin e personelit



për t'u përballur me pasiguritë e mjedisit operacional.

Qëllimi i Iniciativës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Ballkanit është promovimi dhe forcimi i paqes dhe sigurisë rajonale nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak të vendeve anëtare.



Starton “Defender Europe 25”

Më 27 maj nisi nga Shqipëria, stërvitja shumëkombëshe “Defender Europe 25”, një nga stërvitjet më të mëdha dhe më komplekse të dekadës së fundit në Evropë dhe Afrikë. E drejtuar nga Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara (USEUCOM) dhe e zhvilluar në bashkëpunim me vendet aleate të NATO-s dhe partnerët strategjikë, stërvitja do të zgjasë deri më 9 qershor 2025. Në orët e para të mëngjesit, trupat u nisen nga Zall-Herri drejt Qendrës së Stërvitjes në Bizë, ku do të zhvillohen fazat intensive të manovrave ushtarake, përfshirë operacione mësimëse, mbrojtëse dhe dislokime strategjike në terren të vështirë. Stërvitja “Defender Europe 25” ka për qëllim të rrisë gatishmërinë, ndërveprueshmërinë dhe aftësinë e forcave të SHBA-së, NATO-s dhe vendeve partnere për të vepruar në mënyrë të koordinuar në një mjedis të ndërlikuar operativ. Skenari është ndërtuar sipas Nenit 5 të Traktatit të NATO-s, që simulon mbrojtjen kolektive të aleatëve në rast të një sulmi ndaj ndonjërit prej tyre. Aktivitetet ushtarake do të përfshijnë një sërë operacionesh të shkallës së gjerë në disa shtete të Evropës, me fokus të veçantë në Shqipëri dhe Kosovë, ku do të zhvillohen trajnime për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, sigurimin e pikave të imbarkimit dhe menaxhimin e logjistikës së avancuar.



Në ambientet e kinemasë së Garnizonit “Skënderbej”, u zhvillua një aktivitet kulturor me karakter festiv, ku studentët e kësaj akademie performuan një program të pasur artistik me këngë dhe valle tradicionale shqiptare, duke përcjellë vlera të çmuara të trashëgimisë sonë kulturore.

Ky aktivitet kishte për qëllim nxitjen dhe ruajtjen e identitetit kombëtar, përmes integritetit të kulturës popullore në jetën studentore dhe ushtarake. Studentët e Akademisë sollën në skenë motive nga folklori i trevave të ndryshme shqiptare, duke interpretuar me profesionalizëm dhe përkushtim këngë lirike, epike si dhe valle karakteristike të zonave të Veriut, Jugut dhe Shqipërisë së Mesme.

Në fjalën përshëndetëse, përfaqësues të drejtuesve të Akademisë theksuan rëndësinë e edukimit kulturor dhe atdhetar si pjesë përbërëse e formimit të ushtarakut të ardhshëm, duke vlerësuar entuziazmin dhe përgatitjen e studentëve pjesëmarrës.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin pedagogë, oficerë, përfaqësues të institucioneve ushtarake, si dhe familjarë të studentëve, të cilët ndoqën me interes e emocion këtë shfaqje kulturore, duke vlerësuar lart cilësinë artistike dhe mesazhin edukues të saj.

Ky aktivitet dëshmon edhe një herë



Uniforma dhe folklori, bashkë në shërbim të identitetit kombëtar

Akademia e Forcave të Armatosura promovon trashëgiminë kulturore

përkushtimin e Forcave të Armatosura për të zhvilluar dimensionin kulturor të edukimit ushtarak, duke promovuar vlerat më të mira të kombit shqiptar dhe duke nxitur krenarinë për trashëgiminë tonë të përbashkët.





Shqipëria, prioritet investimet në Mbrojtje: Pjesë e Projekteve të Përbashkëta me BE-në për Sigurinë Evropiane

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu zhvilloi një bashkëbisedim të rëndësishëm me ambasadorët e vendeve të Bashkimit Evropian të akredituar në Shqipëri, ku në qendër të diskutimeve ishte rritja e investimeve në mbrojtje dhe zhvillimi i kapaciteteve prodhuese të industrisë ushtarake shqiptare.

Ministri Vengu theksoi se forcimi i shtyllës evropiane të NATO-s është sot një temë kyçe në agjendën euroatlantike dhe Shqipëria është e përkushtuar të luajë një rol aktiv në këtë drejtim. Ai nënvizoi se investimet në mbrojtje nuk kanë vetëm ndikim ushtarak, por sjellin gjithashtu përfitime të prekshme në fusha civile, përmes nxitjes së inovacionit dhe krijimit të vlerës së shtuar ekonomike për vendin.

Në këtë kuadër, ai vlerësoi vendimin e Bashkimit Evropian për të përfshirë Shqipërinë në mekanizmat dhe projektet e përbashkëta në fushën e mbrojtjes, duke e cilësuar këtë, një hap të rëndësishëm drejt integritimit më të thellë të vendit në arkitekturën evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes. Takimi u konsiderua një sinjal i qartë i bashkëpunimit të ngushtë mes Shqipërisë dhe partnerëve të saj evropianë në ndërtimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të qëndrueshëm për të ardhmen.



Gjeneral brigade Aleksandër Pando mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Mjetet e Blinduara në Pragë

U mbajt në Pragë konferenca ndërkombëtare “Future Armoured Vehicles Central and Eastern Europe” (Mjetet e Blinduara të Ardhshme për Evropën Qendrore dhe Lindore), ku morën pjesë drejtues ushtarakë dhe përfaqësues të industrisë së mbrojtjes për të diskutuar zhvillimet më të fundit në fushën e mjeteve të blinduara. Në këtë konferencë të rëndësishme ishte i ftuar dhe mori pjesë edhe gjeneral brigade Aleksandër Pando, komandant i Komandës Mbështetëse. Gjatë konferencës, gjeneral brigade Aleksandër Pando mbajti një prezantim mbi kapacitetet e luftimit dhe mjetet e blinduara si dhe bashkë me pjesëmarrësit e tjerë shkëmbeu ide mbi sfidat në përdorimin mjeteve të blinduara dhe teknologjive të avancuara që po formësojnë aftësitë luftarake të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. Tema kryesore e konferencës ishte modernizimi i platformave ekzistuese të blinduara, rritja e aftësisë dhe mbrojtja e njësive operacionale, roli i sistemeve ajrore pa pilot dhe ato tokësore pa personel (UAS/C-UAS), si dhe sfidat e mbështetjes logjistike në ruajtjen e gatishmërisë luftarake në fushëbetejë. Pjesëmarrësit diskutuan mbi mënyrat më efikase për të përmirësuar mbrojtjen tokësore dhe për të përballuar sfidat e mjedisit bashkëkohor të sigurisë.

Një interes tërhoqi edhe tema “Krijimi i Avantazhit Taktik përmes Sistemeve Moderne të Energjisë”, e cila trajtoi sfidat e integritetit të teknologjive të reja të energjisë në mjetet luftarake, strategjitë për testim në kushte reale dhe me simulator, si dhe ndikimin që sistemet e fuqisë së zjarrit dhe mbrojtjes së ekuipazheve kanë në treguesit dhe performancën operacionale.

Pjesëmarrësit patën gjithashtu mundësinë të angazhohen me kompani udhëheqëse si “RAFAEL Advanced Defense Systems”, “BAE Systems”, ASELSAN, “Pearson Engineering” dhe “Milrem Robotics”, të cilat prezantuan zgjidhjet e tyre më të fundit teknologjike, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi të ardhmen e mjeteve të blinduara në rajon dhe më gjerë, si dhe adresuan iniciativat e përbashkëta nëpërmjet ngritjes së grupeve të punës dhe qendrave të ekselencës si një zgjidhje afatgjatë për të garantuar operabilitetin e sistemeve të blinduara.



Qeveria shqiptare aktivizon rezervistët, ministri Vengu: Forcim i kapaciteteve ushtarake në kohë paqeje

Qeveria shqiptare ka miratuar një vendim të ri që lejon rikthimin e ushtarakëve në rezervë në shërbimin aktiv, me synimin për të forcuar kapacitetet mbrojtëse të vendit. Ky vendim, i propozuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe i miratuar nga Këshilli i Ministrave, u bë publik nga ministri Pirro Vengu, më 29 maj 2025.

Sipas këtij vendimi, individët që kanë shërbyer më parë si oficerë, nënoficerë, ushtarë apo detarë, do të kenë mundësinë të rikthehen në shërbimin aktiv nëse strukturat e mbrojtjes kanë nevojë për ekspertizën apo specialitetin e tyre. Ministria e Mbrojtjes do të publikojë thirrjet për pozicionet e hapura në faqen e saj zyrtare, ndërsa aplikimi do të bëhet në mënyrë elektronike përmes platformës e-Albania.

Kandidatët do të kalojnë një proces përzgjedhjeje që përfshin shqyrtimin e dokumentacionit, kontrollin e sigurisë dhe vlerësimin nga komisionet përkatëse. Ministri Vengu theksoi se kjo masë është e domosdoshme për rienergizimin e ushtrisë shqiptare dhe është mirëpritur nga ushtarakët e tërhequr.

Ekspertët Xhenierë marrin pjesë në pastrimin e territorit nga municionet e rrezikshme në Bashkitë Vlorë, Durrës dhe Sarandë

Specialistët e Kompanisë EOD të Batalionit të Xhenios, në Komandën Mbështetëse janë angazhuar në mbështetje të Autoriteteve Civile me qëllim vlerësimin, largimin, asgjësimin dhe transportimin e municioneve të identifikuara në bashkitë Vlorë, Durrës dhe Sarandë.

Ekspertët xhenierë kanë përfunduar operacionin EOD, duke vlerësuar municionet e gjetura në fshatin Kaninë dhe Qeparo, për të cilët konkluduan se municionet tip predha artilerie janë të prekshme dhe të lëvizshme.

Ekipi tjetër EOD duke zbatuar të gjitha procedurat e parashikuara në manualët përkatëse dhe pas rikonicionit të kryer në fshatin Mursi, njësia administrative Xarrë, bashkia Sarandë vlerësoi se municioni tip granatë dore kundër-këmbësorisë i periudhës së Luftës së Dytë Botërore ishte i paprekshëm dhe i rrezikshëm. Duke ndjekur të gjitha masat e sigurimit teknik ekspertët bënë asgjësimin në vend të municionit me qëllim sigurimin e jetës dhe pronës së banorëve.

Specialistët EOD ndërhyjnë në kantierin e “Yacht Marina”, ku identifikuan dhe vlerësuan se municionet e gjetura, predhë mortaje dhe predhë artilerie të periudhës së Luftës së Dytë Botërore nuk përbënin rrezik për të lëvizur dhe transportuar. Municionet e kalibrave të ndryshëm të kontaktuara dhe vlerësuar nga grupet EOD në bashkinë Vlorë dhe Durrës janë magazinuar në depot e Batalionit të Xhenios në përputhje me të gjitha rregullat e parashikuara për këtë fazë të operacioneve. Batalioni i Xhenios vazhdon të përmbushë misionin e tij për pastrimin e sipërfaqeve tokësore dhe detare nga municionet e rrezikshme dhe të paplasura.





Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dima priti gjeneralletenant Bashkim Jasharin

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Bashkim Jashari zhvilloi një vizitë zyrtare në Bazën Ajrore të Kuçovës. Në këtë vizitë, ai u prit nga komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dima dhe komandanti i Bazës Ajrore të Kuçovës, kolonel Ardian Kuli. Gjatë vizitës gjeneralletenant Jashari u njoh nga afër me kapacitetet dhe infrastrukturën e bazës, e cila është investuar për të përmbushur standardet më të larta të NATO-s, historikun, si dhe projektet për zhvillimin e saj.

Nga ana e tij, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dima, pasi i uroi mirëseardhjen, e vuri theksin në rëndësinë strategjike të bazës, si pjesë e rrjetit të bazave të NATO-s, duke u shndërruar në një qendër moderne për aviacionin dhe sigurinë, jo vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por edhe më gjerë.

Kjo vizitë forcon më tej marrëdhëniet e ngushta mes Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë, duke dëshmuar bashkëpunimin rajonal për sigurinë dhe stabilitetin në Evropën Juglindore.

Baza Ajrore e Kuçovës mbetet një simbol i përkushtimit të Shqipërisë për të kontribuar në arkitekturën e mbrojtjes kolektive të NATO-s dhe një pikë kyçe për koordinimin e operacioneve të Aleancës në rajon.



Anija P-134 “Butrinti” zhvilloi stërvitje në detin Egje

Anija P-134 “Butrinti”, pjesë e misionit në Detin Egje, realizoi një stërvitje në ujërat ndërkombëtare me anijen flamurtare gjermane A1437 “PLANET”, me synim përmirësimin e manovrimit të përbashkët dhe forcimin e bashkëpunimit detar.

Në kuadër të këtij angazhimi, u krye shkëmbim personeli ndërmjet dy anijeve, ndërsa komandanti i P-134 zhvilloi një vizitë në bordin e “PLANET”.

Ky bashkëpunim shënon një tjetër hap drejt forcimit të partneritetit ndërkombëtar dhe rritjes së gatishmërisë operacionale të Forcës Detare/Rojës Bregdetare.



FOCOPS 25-3, përmbyllet me sukses misioni

Efektivët e anijes “LISSUS” P-133 u kthyen në atdhe pas përfundimit me sukses të misionit FOCOPS 25-3. Në një ceremoni të veçantë, ata u pritën nga Komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, nënadmiralet Adnand Agastra, i cili i përgëzoi për përkushtimin, profesionalizmin dhe punën e palodhshme që treguan gjatë kohës së operacionit.

Ky mision shënoi gjithashtu një moment të rëndësishëm bashkëpunimi ndërkombëtar, pasi për herë të parë mori pjesë edhe një oficer nga Mali i Zi, Lejtnant Filip Čorać, i cili shërbeu në bordin e anijes “LISSUS” gjatë misionit, duke kontribuar në shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit detar mes vendeve partnere.

Forca Detare vijon të jetë një kontribuuese e rëndësishme në operacionet ndërkombëtare të sigurisë detare, duke dëshmuar profesionalizëm dhe përkushtim të lartë në çdo angazhim jashtë vendit.



Forca Ajrore angazhohet në stërvitjen “Defender Europe 25”

Forca Ajrore shqiptare ka nisur angazhimin e saj në stërvitjen ndërkombëtare “Defender Europe 25”, e cila zhvillohet me synimin për të ndërtuar një forcë shumëkombëshe të aftë për të ndërvepruar në mjedise operacionale komplekse. Pjesë e kësaj nisme është faza “Reagimi i Menjëhershëm - 25”, ku Forca Ajrore do të luajë një rol të rëndësishëm përmes operacioneve të specializuara ajrore.

Në këtë stërvitje, Forca Ajrore do të përfshihet në planëzim, koordinim dhe zhvillim të detyrave operacionale, duke përdorur aftësitë e saj për të rritur ndërveprimin midis forcave pjesëmarrëse. Synimi është të rritet gatishmëria dhe aftësia për reagim të shpejtë ndaj situatave të mundshme krize, emergjence, si dhe për përmbushjen e kërkesave operacionale.

Një aspekt i rëndësishëm i angazhimit është përfshirja e detashmentit të mjeteve ajrore pa pilotë, për herë të parë në këtë nivel, si dhe përdorimi i Bazës Ajrore Farkë me helikopterët AS532AL “Cougar” dhe UH-60 “Blackhawk”. Forca Ajrore do të marrë pjesë në misione në mbështetje të operacioneve tokësore, transportimin e trupave, sigurimin ajror të konvejerëve, kërkim-shpëtim, si dhe për evakuime mjekësore (MEDEVAC/CASEVAC), sipas skenarëve përkatës. Në kuadër të angazhimit për këtë stërvitje, është planifikuar një koordinim i ngushtë edhe me institucionet civile të menaxhimit të hapësirës ajrore, si “Albcontrol”, për të siguruar menaxhimin e fluturimeve dhe hapësirës ajrore në Poligonin Kombëtar në Bizë. Gjithashtu, bashkëpunimi rajonal me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) do të jetë një element kyç për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj stërvitjeje. Me këtë angazhim, Forca Ajrore shqiptare do të dëshmojë aftësitë dhe përgatitjen e saj për të ndërvepruar në kuadër të forcave ndërkombëtare, duke kontribuar në përmirësimin e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Stërvitja është ende në fazat e saj fillestare dhe premtom të sjellë një eksperiencë të vlefshme për Forcën Ajrore, si dhe për të gjitha forcat pjesëmarrëse.



Përfundoi trajnimi dyditor mbi Luftën Kundër Zjarrit për ushtarakët e Bazës Ajrore Farkë

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Bazës Ajrore Farkë dhe Shoqatës së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, përfundoi me sukses trajnimi dyditor i dedikuar për 20 ushtarakë të bazës.

Trajnimi kishte si fokus rritjen e aftësive praktike të pjesëmarrësve në përdorimin e pajisjeve individuale dhe kolektive për luftën kundër zjarrit. Aktivitetet u zhvilluan përmes simulimit të situatave reale të komandimit dhe kontrollit, duke u siguruar që pjesëmarrësit të përballen me skenarë të ndryshëm emergjence në kushte të ngjashme me ato reale.

Ky trajnim synon të përmirësojë gatishmërinë dhe efikasitetin e personelit ushtarak në përballimin e situatave kritike, duke garantuar një reagim të koordinuar dhe të shpejtë në rast emergjencash.

Shoqata e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit mbetet e përkushtuar për të kontribuar në forcimin e aftësive operacionale të institucioneve vendase në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri.

FORCAT E
Armatosura



DEFENDER
EUROPE
2025



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, Forcat e Armatosura nuk janë vetëm në stërvitje, gatishmëri apo patrullim. Ato janë gjithashtu në zemrën e çdo familjeje që i përket kësaj trupe. Çdo ushtarak/e që kthehet në shtëpi e gjen paqen te zëri i një fëmije, dhe çdo fëmijë që e di që prindi i tij mbron vendin, rritet me një ideal të lartë.

Për të gjithë prindërit me uniformë: gëzuar 1 Qershorin ju dhe fëmijëve tuaj! Falë jush, fëmijët tanë rriten të sigurt, të frymëzuar dhe krenarë.

Kjo intervistë e veçantë nuk flet vetëm për uniformën, disiplinën apo detyrën, por për dashurinë e një babai, forcën e një ushtaraku, dhe ëndrrat e një fëmije, të gjitha të thurura bashkë, nën hijen e një flamuri dhe zemrës së një familjeje ushtarake.

Ndërmjet Atdheut dhe Zemrës

Në periferi të Tiranës, në një lagje të qetë, nën hijen e disa pemëve të blerta dhe cicërimën e zogjve që të kujtojnë fillimin e verës, ndodhet një apartament i ngrohtë dhe i thjeshtë. Është e shtunë paradite, një ditë që për shumë fëmijë nënkupton lodra, liri dhe ëndrra të vogla. Por për vajzën 8-vjeçare, Alaja Bajlas kjo ditë ka një domethënie edhe më të veçantë, babai i saj, majori i Forcave të Armatosura, është sot në shtëpi. Për shumë fëmijë të tjerë kjo është normale, ndërsa për fëmijët e ushtarakëve ky është një 'luks'.

Në një qoshe të dhomës së ndenjes, e cila është zbukuruar me vizatime, libra, medalje dhe një foto të madhe familjare, qëndron uniforma ushtarake e palosur me kujdes, gati për misionin e radhës. Por sot ajo uniformë qëndron pezull. Sepse sot është 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.



Major Genti Bajlas, faleminderit që na hapët dyert e shtëpisë në këtë ditë kaq të rëndësishme! Si ndiheni sot?

Ndihem i privilegjuar që jam në shtëpi. Këto janë ato ditët që, si ushtarak, më mungojnë më shumë. Ndonjëherë mund të mungosh në festa, ditëlindje, apo edhe në çaste të vogla që për fëmijën kanë vlerë të madhe. Por kur je këtu, e ndjen sa shumë peshon kjo kohë. E ndjej veten shumë të

“Heroi im nën Uniformë” Një Bisedë Zemre me Major Genti Bajlas dhe Bijën e Tij, Alaja 8-vjeçare



bekuar. Jo vetëm si ushtarak, por mbi të gjitha si prind. Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura është një mision i shenjtë, por të jesh prind është një bekim. Dhe në këtë ditë, dua t'i përulëm të gjithë fëmijëve tanë që presin me padurim një përqaftim, një fjalë të ngrohtë, një ditë të plotë me prindërit e tyre.

Sa e vështirë është të jesh prind ushtarak?

Është një nga ato sfida që nuk ka manual. Një pjesë e shpirtit tënd është gjithmonë në alarm, në gatishmëri,

në stërvitje, ndërsa pjesa tjetër mundohet të mbajë të paprekur atë lidhje të shenjtë me familjen. Alaja më mëson çdo ditë çfarë do të thotë durim, mirëkuptim dhe dashuri e pakushtëzuar. Është një sfidë që nuk e fiton gjithmonë, për fat të keq. Ka momente kur jam në terren, jashtë shtetit në misione paqeruajtëse, apo në stërvitje të gjata dhe nuk jam aty kur Alaja ka koncertin e shkollës, apo kur thjesht ka nevojë për ndihmë në detyrat e shtëpisë. E vogla jonë çdo ditë na thotë se: dashuria nuk matet me orë, por me praninë që mbetet edhe kur nuk je fizikisht aty.



Ka pasur ndonjë moment të veçantë që ju ka prekur si prind?
Po, shumë... Shpesh, më ndodh të jem me ditë të tëra larg familjes, dhe Alaja më dërgon letër ku shkruan: “Babi, unë e di që ti je atje sepse po na mbron. Mos u mërzit që nuk ishe në koncertin tim, unë e këndova këngën vetëm për ty”. E lexova atë letër në një çadër ushtarake, dhe sytë mu mbushën me lot. Në ato momente ndjen sa shumë sakrifikon, por edhe sa shumë fiton kur je prind.



Alaja e vogël na bashkohet për t’i dhënë ngjyra dhe jetë kësaj interviste.
Alaja, çfarë ndjen kur babi është larg në mision?
Në fillim mërzitem. Sidomos kur kthehem nga shkolla dhe e di që nuk është në shtëpi. Më mungon shumë kur është

larg, por e di që po bën diçka të rëndësishme. Kur e shoh me uniformë, ndjej krenari, si kur shoh një superhero. Dhe pastaj mamaja më tregon se ku është dhe pse ka shkuar... Kur flasim me video, i tregoj çfarë kam vizatuar, dhe ai më thotë që do t’i varim në mur kur të vijë. Kur kthehet, e përqafoj fort dhe ndihem e lumtur.. shumë e lumtur...



Çfarë e bën babin të veçantë për ty?
Ai më dëgjon gjithmonë. Edhe kur nuk është këtu, më

shkruan mesazhe, më pyet për notat, për shoqet. Kur është me mua, nuk përdor telefonin fare, jemi vetëm ne të dy. Babi më thotë se një ushtarak i mirë është edhe një baba i mirë.

Çfarë dëshiron t’i thuash babit sot, në këtë ditë të veçantë?

I them: faleminderit që gjithmonë përpiqesh të jesh këtu! Edhe kur nuk është fizikisht, e ndiej që është me mua. Babi, të dua shumë!

Në fund të intervistës, pasi Alaja i dhuroi babait një vizatim ku kishte vizatuar një familje me flamurin shqiptar mbi kokë dhe një ushtar që mban për dore një fëmijë, majori ndalet, mban frymën për pak dhe thotë: “Ne ushtarakët shpesh herë kemi imazhin e burrit të fortë, të disiplinuar, të heshtur. Por brenda nesh ka një zemër që rreh fort për njerëzit që lëmë pas. Fëmijët tanë janë motivi që na ngre çdo mëngjes dhe na jep forcën për të përballuar çdo sfidë”.

Në këtë 1 Qershor, mes shumë aktiviteteve, dhuratave dhe festimeve, le të mos harrojmë fëmijët e atyre që shërbejnë me përkushtim në mbrojtje të Shqipërisë. Le t’u japim atyre kohë, dashuri dhe siguri, sepse prindërit e tyre japin gjithçka për të na garantuar një të ardhme më të mirë.

Në një shoqëri që kërkon gjithnjë e më shumë që forcat e sigurisë të jenë të afërta me komunitetin, figura e ushtarakut prind është një model frymëzues për të gjithë, një njeri që në emër të vendit e jetës, bën gjithçka për paqen, dhe që në zemrën e vet mban fëmijën e vet si motivin më të madh për të vazhduar përpara.

Gëzuar 1 Qershorin të gjithë fëmijëve shqiptarë!



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Emigracioni është një plagë e hapur e historisë shqiptare, por njëkohësisht edhe një dëshmi e mbijetesës sonë si komb. Në çdo kohë, në çdo kontinent, shqiptarët janë shpërndarë si gurë të një mozaiku që, ndonëse i shpërndarë, ka ruajtur ngjyrën dhe formën e vet: Nga Arbëreshët te Amerika – 500 vjet mërgim dhe shqip dhe gjallë.

Valët e para të emigracionit shqiptar nisin që nga shekulli XV, pas vdekjes së Skënderbeut, kur mijëra shqiptarë u zhvendosën drejt Italisë. Arbëreshët u vendosën në Kalabri, Siçili e Pulia, ku ruajtën për shekuj me radhë gjuhën, zakonet dhe ndjenjën kombëtare. Edhe pse lindën e vdiqën në një vend tjetër, kur u këndonin ninulla fëmijëve, kur luteshin, kur qanin – e bënë vetëm shqip. Sot, në shumë fshatra arbëreshe, fëmijët ende mësojnë të thonë “jam arbëresh, flas gjuhën e të parëve”.

Mërgata e Rilindjes, kur fjala shqipe u bë ideologji

Në shekullin XIX, emigrantët shqiptarë në Egjipt, Rumani dhe SHBA nuk kishin vetëm mision ekonomik, por edhe një mision historik: rilindjen kombëtare përmes gjuhës. Ata themeluan shoqëri kulturore, klube, shkolla dhe gazeta në shqip. Në Sofje, Stamboll, Kajro, Boston, ushtarë e intelektualë përgatitën terrenin për Pavarësinë e 1912-ës – dhe shqipja ishte “arma” me të cilën rroknin ndërgjegjen kombëtare.

Gjuha që bëhet kushtrim

Në Luftën e Dytë Botërore dhe në Luftën e Kosovës, mërgata shqiptare nuk qëndroi spektatore. Me ndihmë financiare, propagandë dhe vetë pjesëmarrje fizike, ata treguan se mërgimi nuk e shuan ndjenjën kombëtare, por e ndez edhe më shumë.

Shqiptarë nga diaspora, sidomos nga Gjermania, Zvicra dhe SHBA, u kthyen për të luftuar për lirinë e Kosovës, duke lënë pas jetën e rehatshme për një ideal. Ndonëse mund të mos e kishin shqipen të përkryer, kur dëgjuan për masakrat dhe dhunën, zemra u foli shqip.

Gruaja shqiptare në emigracion, mbrojtësja e gjuhës dhe e shpirtit

Në gjithë këtë histori mërgimi, një figurë del në pah me një rëndësi të jashtëzakonshme: gruaja shqiptare. Ajo ka qenë mbajtësja e gjuhës në shtëpi, mësuesja e fëmijëve, ruajtësja e zakoneve dhe e kujtesës.

Në mërgatë, shumë burra punonin jashtë, ndërsa gratë kujdeseshin që fëmijët të rriteshin me ndjenjën e të qenit shqiptar dhe kjo fillonte nga gjuha. Nga nëna që në Bruksel u mëson fëmijëve abetaren shqip pas mësimit frëngjisht, te gjyshja në Bronx që i përcjell nipit historitë e Skënderbeut,



gruaja shqiptare është shtylla e identitetit në mërgatë. Ajo është edhe zëri i përmalluar i videos në WhatsApp, që i thotë djalit në Gjermani: “Mos harro, bir, kush je dhe nga vjen”. Dhe kur dhimbja i rëndon mbi sup, nuk ankohet në asnjë gjuhë tjetër – lotin e derdh shqip.

Sot, kur gjuha është ura me atdheun

Në kohët moderne, diaspora shqiptare është e përhapur në të gjithë globin. Por tashmë nuk është më vetëm sfidë mbijetese – është sfidë identiteti. Në një botë ku asimilimi ndodh natyrshëm, ruajtja e gjuhës është akt vullneti dhe dashurie. Në këtë sfond, shkollat shqipe në diasporë, organizatat kulturore, aktivitetet kombëtare si “Dita e Alfabetit”, janë misione të përbashkëta të mbrojtjes së shpirtit kombëtar në dhe të huaj.

Në të gjitha gjuhët mund të flas për integrim, për shkollim, për jetesë. Por kur më dhemb shpirti, për mallin e vendlindjes, për varrin e prindit, për një këngë që s’harrohet, unë bërtas shqip.

Gjuha shqipe nuk është vetëm fjalor është gjaku që nuk bëhet ujë, është loti që nuk përkthehet. Në çdo cep të botës ku ka një shqiptar, shqipja është flamuri që valon pa shtizë, është betimi që bëhet pa zë, është përqaftimi që kthehet në lutje. Dhe për sa kohë nënat tona do t’u thonë fëmijëve “Mos harro gjuhën tënde”, ky komb nuk do të shuhet kurrë.

Gjuha, Nëna dhe Atdheu – Zemra e Identitetit Kombëtar

Identiteti kombëtar nuk është thjesht një fjalë që përdoret në librat e historisë apo në fjalimet politike. Ai është një ndjenjë, një përkatësi, një gjendje shpirtërore që lind me ne dhe rritet bashkë me ne. Është mënyra si e ndiejmë veten pjesë e një populli, e një kulture, e një trashëgimie që na jep emër dhe dinjitet. Për shqiptarët, kjo ndjenjë mishërohet përmes tri shtyllave të shenjta: gjuhës shqipe, nënës shqiptare dhe atdheut tonë.

Gjuha – Pasaporta e përjetshme e Kombit

Gjuha shqipe është më shumë se një mjet komunikimi. Ajo është një monument shpirtëror, një dëshmi e ekzistencës sonë si popull. Me rrënjë të thella në historinë ilire,

gjuha jonë ka mbijetuar pushtime, ndalime, përbuzje, por nuk është zhdukur kurrë. Ajo ka qenë gjithmonë aty, në këngët e nënave, në përrallat e gjyshërve, në fjalët e dashurisë dhe në betimet për liri.

Gjuha shqipe është një nga pasuritë më të mëdha që kemi si komb. Ajo përmbledh brenda vetes gjithë rrugëtimin tonë si popull, me të gjitha dhimbjet dhe lavditë. Është përmes saj që jemi lexuar nga bota, dhe është përmes saj që kemi folur me botën. Të shkruash e të flasësh në shqip është të ndjesh gjakun që të rrjedh me krenari në deje.

Ruajtja e gjuhës është ruajtja e vetvetes. Në një botë që po globalizohet me ritme marramendëse, ku gjuhët e vogla rrezikojnë të zëvendësohen nga gjuhë të mëdha e ndërkombëtare, shqipja ka nevojë për dashurinë tonë të përditshme. Sa herë zgjedhim të flasim në shqip, ta shkruajmë saktë, ta mësojmë me përkushtim, ne po e mbrojmë identitetin tonë nga harrimi.

Nëna – Rrënja e çdo shqiptari

Nëna është ajo që na jep jetën, por është edhe ajo që na jep gjuhën, dashurinë për atdheun, dhe edukatën për të qenë njeri. Nga përqaftimi i saj marrim mësimet e para për jetën dhe për botën. Nëna është mësuesja e parë, historiani i parë, atdhetarja e parë që njohim. Në zërin e saj dëgjojmë të kaluarën dhe shpresën.

Përmes nënës mësojmë ç’është sakrifica, durimi, krenaria. Ajo na mëson të jemi të ndershëm, të kujdesshëm, të guximshëm. Shpesh thuhet se kombi është aq i fortë sa janë nënat e tij. Dhe nënat shqiptare, përgjatë historisë, kanë qenë shembull i forcës dhe i dashurisë. Në kohë luftërash kanë rritur bij të lirisë; në kohë paqeje kanë rritur bij të dijes dhe punës.

Figura e nënës shqiptare është një pasuri që nuk mund të matet me fjalë. Ajo është kudo: në letërsinë tonë, në këngët popullore, në legjendat tona, në përditshmërinë tonë. Ta nderojmë nënën është të nderojmë rrënjët, gjuhën dhe historinë.

Atdheu – Gjaku dhe toka që na lidh me njëri-tjetrin

Atdheu është më shumë se një copë tokë. Atdheu është dheu i të parëve tanë, është historia që kemi trashëguar, është flamuri që

valëvitet në erë kur ndiejmë krenari. Është gjuha që flasim, emri që mbajmë, dhe kënga që këndojmë në ditë gëzimi apo malli.

Të duash atdheun nuk është vetëm ndjenjë, është përgjegjësi. Është ta ruash mjedisin, ta respektosh ligjin, të kontribuosh me dije e punë. Atdheu nuk është vetëm Shqipëria apo Kosova si shtete – është çdo fshat, çdo qytet, çdo gur i lashtë, çdo histori familjare që mban gjallë kujtesën e kombit.

Për shqiptarët, atdheu është tokë që është mbrojtur me gjak. Historia jonë është histori e përpjekjes për liri dhe dinjitet. Prandaj ndjenja për atdheun është e thellë, ndonjëherë edhe e dhimbshme, por gjithmonë krenare. Ne jemi të lidhur me atdheun si me një prind, si me një zemër që rreh për të gjithë.

Identiteti kombëtar

– Një thesar që duhet ruajtur

Kur flasim për identitetin tonë kombëtar, nuk flasim për një koncept abstrakt. Ai është i prekshëm: në gjuhën që flasim, në nënën që na rriti dhe në atdheun që na jep përkatësi. Identiteti ynë është ai që na bën shqiptarë, pavarësisht vendit ku jetojmë. Ai na mbron nga asimilimi, nga harresa, nga humbja e vetes.

Sot më shumë se kurrë kemi nevojë ta forcojmë këtë identitet. Në shkolla, në familje, në media, në jetën e përditshme. Të mos na vijë turp nga gjuha jonë, por të ndiejmë krenari. Të mos harrojmë sakrificën e nënave tona dhe të mos rrimë indiferentë ndaj fatit të atdheut.

Ne jemi brezi që duhet ta mbajë gjallë këtë identitet. Dhe kjo nis me fjalën e parë që themi, me respektin që kemi për nënën, dhe me dashurinë që ushqejmë për tokën tonë. Identiteti nuk është vetëm një kujtim i së kaluarës, por një udhërrëfyes për të ardhmen tonë.

Gjuha, nëna dhe atdheu, janë tre thesare që çdo shqiptar duhet t’i mbajë në zemër. Ato janë të shenjta, të përjetshme dhe të pandashme nga njëra-tjetra. Në to qëndron forca jonë, historia jonë dhe e ardhmja jonë.

Ta duam shqipen, ta nderojmë nënën dhe ta mbrojmë atdheun – sepse vetëm kështu do të mbetemi krenarisht shqiptarë, kudo që të jemi dhe kurdo që të jetojmë.

Përkatësia krahinore, element pasurues i identitetit të përbashkët profesional dhe kombëtar

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Analiza e krahinizmave në Shqipëri kërkon një vështrim të thelluar sociologjik, psikologjik dhe historik, duke trajtuar të përbashkëtat dhe ndasitë mes krahinave, si dhe mënyrën se si shoqëria shqiptare i percepton këto dallime, përfshirë edhe përdorimin e termave “diskriminues”, shpesh me ngarkesë negative apo përcmuese.

Krahinizmat në Shqipëri: Thelb dhe Origjinë

Krahinizmi i referohet një forme identiteti lokal ose rajonal që shpesh ndikon në mënyrën si njerëzit e perceptojnë njëri-tjetrin brenda një kombi të vetëm.

Në Shqipëri, për shkak të relievit të thyer, mungesës së gjatë të një shteti qendror dhe ndikimeve osmane, venedikase dhe më pas komuniste, u krijuan krahinizma të forta. Krahinat kryesore (në ndarje tradicionale kulturore): Veriu (Malësia, Dukagjini, Tropoja, Mirdita etj.), Shkodra (si qytet me identitet të fortë qytetar); Zona e Mesme (Tirana, Elbasani, Durrësi); Jugu (Gjirokastra, Vlora, Tepelena); Juglindja - Korça, Pogradeci, Erseka, Bilishti.); Labëria dhe Çamëria (me identitete specifike).

Të Përbashkëtat mes Krahinave

Gjuha: Edhe pse ka dialekte të ndryshme (gegë dhe toskë), gjuha shqipe është baza e përbashkët kombëtare. Të gjitha krahinat ndajnë një fond të përbashkët leksikor dhe gramatikor.

Kultura mikpritëse: Pothuajse çdo krahinë në Shqipëri ka vlera të forta mikpritjeje dhe nderimi për mysafirin.

Nderi dhe burrëria: Në shumë krahina, sidomos në Veri, por jo vetëm, nderi shihet si virtyti më i lartë, një vlerë që gjen jehonë edhe në krahinat e tjera në forma të ndryshme.

Ndasi dhe stereotipe krahinore

Psikologjia krahinore është formuar në varësi të faktorëve historikë, gjeografikë dhe ekonomikë:

Veriorët (malësorët) perceptohen si më të rreptë, më të drejtë e tradicionale, por ndonjëherë si të “ashpër”, apo “të prapambetur” në sytë e jugorëve.

Jugorët shihen si më të qytetëruar, më të butë në komunikim, por ndonjëherë edhe si “dinakë” apo “dyfytirësh” në perceptimin e disa veriorëve.

Tirana dhe zona e mesme luajnë shpesh rolin e “arbitrit”, por përjetojnë ndikime nga të dy krahët, nga njëra anë “me të përparuara” por shpesh të akuzuara për “shtirje” ose “snobizëm”.

Termi “verior”: Origjinë, evoluim dhe perceptim

Termi “verior” vjen nga “malësor”, që do të thotë banor i maleve. Në vetvete, nuk ka ngarkesë negative. Por në zhvillimet urbane të Shqipërisë, veçanërisht pas viteve '90, ky term mori kuptime përcmuese.

Si përdoret: Negativisht (urbane): Në qytete si Tirana, “verior” shpesh përdoret për të përshkruar dikë që shihet si i paarsimuar, i ashpër, apo me sjellje “primitive”.

Neutral/pozitivisht (brenda krahinës): Në Veri, vetë-identifikimi si “malësor” është burim krenarie, jo turpi. Një “verior i mirë” mund të shihet si njeri i besës, i drejtë, i pa korruptuar.

Psikologjikisht: Përdorimi i termit si fyerje tregon paragjykim krahinor, mungesë integrimi kulturor dhe një ndarje që Shqipëria moderne përpigjet ta tejkalojë.

Pasojat shoqërore të krahinizmit

Përçarje politike: Në shumë raste, politikanët kanë përdorur krahinizmin për të ndarë elektoratin (p.sh. “jugorët janë më të afërt me partinë X”, “veriorët më të dhënë pas Y”).

Migrimi i brendshëm: Lëvizjet nga Veriu në Tiranë shpesh janë shoqëruar me tensione sociale dhe etiketime krahinore.

Ndikimi në ndërveprimet sociale: Ka pasur raste diskriminimi në punësim, arsim apo media bazuar në prejardhje krahinore.

Si mund të tejkalohet kjo ndasi?

Edukimi: Rritja e ndërgjegjësimit mbi pasurinë kulturore të çdo krahine.

Integrimi kulturor: Promovimi i ngjarjeve kulturore që nxisin bashkëveprimin e krahinave. Mediat dhe gjuha publike, si dhe përdorimi korrekt i termave dhe shmangia e etiketimeve përcmuese.

Ndërtimi i një identiteti kombëtar të përbashkët: Pa mohuar veçantitë lokale, por duke i parë ato si pjesë të mozaikut shqiptar. Krahinizmi është një realitet kompleks në Shqipëri. Ai mbart elementë të identitetit, por edhe rrezikun e përçarjes nëse ushqehet me stereotipa e paragjykime.

Në një shoqëri me homogenitet relativ gjuhësor dhe kombëtar si Shqipëria, ndasitë krahinore vijnë të jenë një faktor i rëndësishëm që ndikon në ndërtimin e identitetit individual dhe kolektiv. Këto



ndasi manifestohen jo vetëm në zakone dhe tradita, por edhe në gjuhë, qëndrime, sjellje dhe perceptime.

Identiteti social dhe ndarjet krahinore

Sipas teorisë së identitetit social të Tajfel dhe Turner (1979), individët priren të kategorizojnë veten dhe të tjerët në grupe sociale (“ne” kundër “atyre”) për të ruajtur vetëvlerësimin dhe përkatësinë. Në Shqipëri, ndarja Veri-Jug, apo qytet-fshat, shpesh funksionon si ndarje “ingroup-outgroup”, ku grupi i vet perceptohet më pozitivisht, ndërsa tjetri nënvlerësohet ose përcmohet.

Krahinizmi në këtë kontekst mund të shihet si formë e etnocentrizmit të brendshëm, ku ndarja brenda një kombi homogjen nxit ndjesi superioriteti apo inferioriteti krahinor.

Ushtria është institucioni që, teorikisht, përfaqëson neutralitetin absolut dhe unitetin kombëtar. Megjithatë, edhe brenda strukturave ushtarake, krahinizmi në Shqipëri ka lënë gjurmë të ndjeshme.

Krahinizmi dhe rekrutimi ushtarak në Shqipëri

Para viteve '90: Ushtria shqiptare në kohën e komunizmit synonte unifikimin ideologjik dhe rajonal. Megjithatë, në praktikë, kishte preferenca të qarta krahinore, sidomos në nivelet e larta të komandës.

P.sh., gjatë regjimit të Enver Hoxhës, oficerët nga Jugu (Gjirokastrë, Tepelenë, Vlorë) kishin dominancë në strukturat komanduese, çka krijoi perceptime diskriminuese nga krahinat e tjera, veçanërisht Veriu.

Pas viteve '90: Rënia e sistemit qendror dhe liberalizimi sollën pluralizëm në përfaqësim, por edhe politizim të ushtrisë, ku lidhjet krahinore, partiake dhe personale shpesh ndikonin në emërimet dhe ngritje në detyrë.

Brenda një strukture të mbyllur dhe të disiplinuar si ushtria, formimi i nën-grupeve (p.sh. ushtarë nga e njëjta krahinë) është një fenomen i zakonshëm. Kjo shpesh ndodh për arsye gjuhe, kulture, humorit të përbashkët. Nuk ndodh kjo tek oficerët, të cilët janë të prirur mos tregojnë preferencë për ushtarë apo kolegë me prejardhje të ngjashme rajonale.

Në psikologjinë ushtarake, forma e etiketimit përbën kërcënim për kohezionin e grupit dhe krijon një ambient armiqësor të brendshëm.

Megjithëse ushtria synon të jetë një forcë unifikuese dhe kombëtare, ajo nuk është immune ndaj dinamikave krahinore që mund të minojnë strukturën dhe efektivitetin e saj.

Sot përkatësia krahinore nuk është faktor ndarës, por një element pasurues i një identiteti të përbashkët profesional dhe kombëtar. Për të realizuar këtë analizë mu desh t'i referohem studiuesve të ndryshëm ndërkombëtarë, ku kuptova se ‘paragjykimet’ dhe ‘vlerësimet’ janë pjesë e realitetit edhe në botën e qytetëruar dhe evropianizuar shumë shekuj para. Humanët priren të pranojnë më shpejt kulturën, gjuhën dhe besimin, të cilin e kanë më pranë natyrale së tyre dhe më pas përshtaten, kjo është ajo që quhet ‘bashkëjetesë’ e shëndetshme.

Origjina gjeografike dhe përkatësia sociale nuk përbën status dhe nuk të jep privilegj në shoqëri

Referenca: Tajfel, H., & Turner, J. C. (1979). An integrative theory of intergroup conflict. Allport, G. W. (1954). The Nature of Prejudice. Gaertner, S. L., & Dovidio, J. F. (2000). Reducing Intergroup Bias: The Common Ingroup Identity Model. Kelman, H. C., & Hamilton, V. L. (1989). Crimes of Obedience. Janis, I. L. (1972). Groupthink.

Skënderbegasi Beshir Roka, shkrimtar dhe publicist i njohur

Beshir Novrus Roka ka lindur, më 12 shtator 1949, në Bylysh të Tepelenës. Shkollën ushtarake “Skënderbej” e ka kryer në vitet 1963-1967, me rezultate mjaft të mira. Ato vite, të gjithë skënderbegasit që mbaronin shkëlqyeshëm dërgoheshin për studime në Universitetin e Tiranës. Kështu në 1968-1972, studioi në Fakultetin e Historisë, në degën Histori-Gjeografi. Pas një kursi pasuniversitar ushtarak në vitet 1972-1973, titullohet oficer aktiv më 1973. Nis punën si pedagog filozofie në shkollën e kuadrove të Korpusit Vlorë, për të vazhduar në detyrat shef kulture i brigadës artiljere, shef zbulimi grupi, shef i propagandës dhe kulturës në korpus dhe instruktor për edukim kulture në Ministrinë e Mbrojtjes, deri në vitin 1992, kur del në rezervë.

Ai punoi për disa vite mësues i historisë dhe në vitin 1999 emërohet specialist për marrëdhënie me publikun, në Ministrinë e Mbrojtjes. Në vitin 2000 emërohet drejtor i Qendrës Kulturore të Forcave të Armatosura deri në fund të vitit 2002. Më tej kreu detyrat si shef i degës së Marrëdhënieve Civile Ushtarake në Komandën e Forcave Tokësore, si dhe kryeredaktor i revistës “Tokësori” në vitet 2003-2005.

Në fillim të muajit mars 1999, u emërua në Ministrinë e Mbrojtjes, në Drejtorinë e Marrëdhënieve Publike, i shkëputur nga FA-të nga korriku i vitit 1992. E nisi punën kur ethet e luftës, ose të një prag-lufte, kishin përfshirë Veriun e Shqipërisë, por ndihej kudo dhe në vend. Kjo vërehej qartë nga mos nënshkrimi i marrëveshjes në Konferencën e Rambujesë nga pala serbe, dhe se lufta po trokiste në kufijtë veriorë të Shqipërisë. Ushtria shqiptare, pas shkatërrimit absurd të vitit 1997, ishte ngritur dhe, me stërvitje intensive në veri të vendit, në veçanti në rajonin e Divizionit të Kukësit, ishte e aftë dhe e organizuar për të përballuar çdo provokim e sulm të mundshëm të ushtrisë serbe. Ushtarakët e këtij divizioni kishin më shumë se 17 muaj në gatishmëri luftarake, ku ditë e natë qëndronin në vrojtje e vëzhgim të pandërprerë. Beshiri, në librin “Nga pragu i luftës në paqe” shkruan se këtë periudhë tepër të vështirë e kam përjetuar me emocione të mëdha për sakrificat që bënë këta oficerë e ushtarë heronj. Nisur nga këto përjetime në kohën e krizës dhe të përballimit të konfliktit në Veri nga Forcat tona të Armatosura, në mënyrë modeste, kam paraqitur kronologjikisht një ditar nëpërmjet reportazheve, kronikave e skenarëve letrarë.

Ja çfarë shkruan ai në librin e tij “Ditë e hapur” në Divizionet “Labëria” dhe “Morava”:

“...Në njësi dhe reparte të ushtrisë po praktikohen eksperiencat të ushtrive të NATO-s, në fushën e marrëdhënieve publike. Kjo edhe si rezultat i një pune këmbëngulëse dhe kërkuese të drejtorisë së marrëdhënieve publike. E veçantë është për t’u përmendur shkëmbimi i përvojës me ushtritë e NATO-s dhe me ato të partneritetit. Mjaft kuadro kishin marrë kualifikimin e domosdoshëm në shumë ushtri si në SHBA, Angli, Itali, Gjermani në Zvicër e tjera. Këto kualifikime dhanë frytet e veta. Në divizionin ‘Labëria’ në Gjirokastrë u organizua ‘Ditë e hapur’. Populli i Gjirokastrës e ndoqi nga afër këtë aktivitet dhe e vlerësoi për vlerat dhe emocionet që iu krijoi. Thëksin e këtij aktiviteti - thotë Beshiri, - e vendosëm tek një problem të karakterit praktik dhe metodik, duke i dhënë ‘Ditës së Hapur’ misionin që ‘Ushtria është nderi i kombit’. Krijimi i modelit të ditës së hapur sipas përvojës së ushtrive të NATO-s, si dhe propagandimi i arritjeve të divizionit në drejtimet kryesore të veprimtarisë së tij në fushën e gatishmërisë e të përgatitjes luftarake, të forcimit të lidhjeve të ushtrisë me popullin, të konsolidimit të bashkëveprimit me organet e pushtetit lokal, organizatat jo qeveritare dhe institucionet shtetërore, ishte një prurje e re dhe e gjetur për kohën dhe momentin. Tërë aktiviteti pati një strategji, në realizimin e vazhdimësisë dhe krijimit të një përvoje të re me qëllim që publiku i gjerë të afrohet në repartin ushtarak, ta



ndiente veten si pjesë përbërëse të ushtrisë, dhe të rriste interesimin për problemet e ushtrisë dhe të vetë ushtaraku për t’u integruar më mirë në jetën shoqërore. Publiku i gjerë i rretheve të Jugut e në veçanti populli i Gjirokastrës, efektivat aktive të divizionit ‘Labëria’, familjet e ushtarakëve, prindër të ushtarëve, veteranë dhe familje dëshmorësh, familje të ushtarakëve të rënë në krye të detyrës; nxënës shkollash, studentë të rinj; punonjës të institucioneve shtetërore dhe të organizatave jo qeveritare; deputetë e pushtetarë lokalë të Jugut, përfaqësues të organizmave ndërkombëtarë, gazetarë të medias lokale qendrore e ndërkombëtare, përfaqësues të institucioneve e besimeve fetare. Pocest 1999: Sapo hyn në repartin e shumë njohur të brigadës së tankeve, ve re një pamje festive, ku në një parullë të madhe shkruhej ‘Portat e hapura-99’, Pocest. Në këtë ditë festive qindra njerëz, prindër dhe të afërm të ushtarëve të kësaj njësie, veteranë të LANÇ-it, ushtarakë në rezervë, që kanë lidhur jetën me ushtrinë dhe repartin tankist, përfaqësues të pushtetit lokal, kishin ardhur dhe mbushur të gjitha ambientet e njësisë tankiste”. Beshir Roka kujton se mbi të gjitha të binte në sy ardhja e fëmijëve artistë dhe të ushtarakëve të brigadës. “Kjo përvojë e re që zbatohej në ushtritë perëndimore të NATO-s, ‘Ditë e hapur’, ishte një veprimtari e bukur, një përvojë e re, me informacion të dobishëm, ku u dha qartë mesazhi se populli i komunitetit ka një zemër me ushtrinë, jeton me të dhe e quan veten të radhitur me strukturën ushtarake

të garnizonit.”

Në veprimtarinë e tij studimore, Beshir Roka na vjen fillimisht me vëllimin me tregime “Zhgënjimi”, në vitin 1996 dhe novela me titull “Kur u gdhimë Evropë”, të botuar në vitin 1999. Ndërsa në vitin 2000 boton vëllimin “Kush e ndolli errësirën”, për t’u pasuar me vëllimin me poezi “Në varkën e Noes”, të botuar në 2001. Vëmendje i ka kushtuar botimit të monografive si “Nga pragu i luftës në Paqe” në vitin 1999, “Mirënjohje Zvicër” në vitin 2002, “Copëza jete me Tokësorë”, në vitin 2003 dhe në vitin 2005 “Ndjema zemrën Berlin”.

Ai është marrë dhe me përkthime, ku vend zënë dhe botimet për “Doktrinë NATO për CIMIC 2004-2005”, “Civil military realitionsip in complex emergencies; an ISAC reference paper 28 June 2004” dhe “Civil military cooperation: a new tool for peacekeepers”, në vitin 2005.

Gjithashtu ai ka realizuar dhe dokumentarë të publikuar në RTSH, si “Ditë qëndrese 1999”, “Ushtria midis dhimbjes dhe mbrojtjes”, “Ditë të hapura në Divizionin Labëria dhe Morava”, etj.

Për punë të kujdesshme dhe veprimtari të larmishme në detyrat e kryera në vite është dekoruar me “Urdhrin e Shërbimit Ushtarak, Klasi III”, medalje të “Shërbimit Ushtarak” dhe medalje “Për shërbime të shquara”, si dhe mjaft certifikata, fletëlavdërimi dhe nderi etj.

Avni Skënderi, oficeri i karrierës, poeti e publicisti ushtarak

Një nga poetët dhe publicistët ushtarakë, që ka studiuar në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, është dhe mallakastrioti Avni Skënderi. Ai ka qenë skënderbegas i periudhës 1962-1966 dhe ka një karrierë të gjatë dhe të suksesshme në Forcat e Armatosura. Njëkohësisht, krahas disa librave profesional, ai ka botuar ndër vite edhe disa libra me poezi e publicistikë, duke qenë vazhdimisht i pranishëm në median e kohës me krijimet e tij.

Avni Skënderi lindi, më 4 tetor 1950, në Ninësh të Mallakastrës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shtatëvjeçaren në shkollën “Gjok Doçi” Fratar. Vioi studimet në Tiranë në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”, shkollën e lartë të Bashkuar të Oficerëve në specialitetin e Artilerisë Kundërajrore, Akademinë e Mbrojtjes, si dhe studime pasuniversitare për Artin Ushtarak, Filozofi e gjuhë angleze. Shërbeu si oficer 35 vjet në reparte ushtarake, në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Komandën e Forcave Ajrore, duke kryer detyra të ndryshme si komandant baterie, komandant grupi kundërajror, shef operativ regjimenti, shef shtabi regjimenti, shef i degës së stërvitjes e shef i degës operative në Komandën e Mbrojtjes Kundërajrore, shef i përgatitjes së shtabeve në Komandën e Forcave Ajrore.

Doli në rezervë në shtator 2004. Bashkëpunëtor i shtypit ushtarak të kohës. Banon në Tiranë. Ka dy vajza e një djalë dhe një mbesë e tre nipa. Është autor i librave: “Mbrojtja Kundërajrore e Shqipërisë”; “Në roje të Qiellit”; “Komandanti Maqo Zoto”; “1997 - ditët e tmerrit në një ditar”; “Më shumë dritë” (poezi); “Ditari i shpirtit tim”(poezi).

Mes mesazheve të shumtë elektronike dhe mediatike (botime në gazeta, diskutime në TV), teksa përgatiten volumet e kolanës “Skënderbegasit ndër vite...”, është dhe një urim me fjalë zemre i skënderbegasit poet, Avni Skënderi. Vlerësimi shoqërohet dhe me poezinë interesante me titull “Shkollë legjendë”, që i kushtohet shkollës “Skënderbej”. Në përshëndetjen e Skënderit thuhet: “Përshëndetje zotërinjtë Kujtim Boriçi dhe Maksi Fejzulla! Unë jam skënderbegas i viteve 1962-1966. “Shkollë legjendë” e shkrova pesë vjet më parë. Në rrjete sociale, mendoj se është pëlqyer nga skënderbegas dhe të tjerë. Shpresoj t’ju pëlqejë edhe ju si autorë të librit tonë të madh në vlera, disa-volumesh ‘Skënderbegasit ndër vite’. Lexim të mbarë dhe respekt. Nga Avni Skënderaj”.

Ja dhe vjersha e poetit ushtarak, Avni Skënderi, me titull “Shkollë legjendë”, përfshirë në këtë libër: “Në rrugën e Dibrës,/ Këtu në Tiranë,/ Porta e shkollës time,/ Shkollë me kujtime./ Porta është aty,/ Nuk e shkullën./ Shkolla jo,/ E mbyllën!/ Në vitet 90-të,/ Një djallëzor,/ Mbylljen firmosi,/ U thaftë ajo dorë!/ Ku është fidanishtja,/ E fidanëve të rrallë?/ E prishën,/ Të marrët vandalë./ Ku është flamuri,/ Para tij u betuam?/ E leckosën,/ E përdhosën!/ Korifenjët e Kombit,/ Të deshën, të ëndërruan,/ Shkatërrimtarët jo,/ Të eliminuan!/** Para portës ndalem,/ Gjunjët më dridhen,/ Nuk eci dot,/ Në kujtime kridhem./ Kujtime ku më çoni,/ Ndalni një çast,/ Mos më torturoni,/ Zemra po më plas./ Në cep të mustaqes,/ Lotin lëpij,/ Jam 70 vjeç, Nuk jam fëmijë!/ Në syrin e gjyshit,/ Loti nuk shkon./ Është lot hidhërimi,/ Begsi më kupton./ *** Me nostalgji,/ Legjendën kujtova,/ Udhën e dijes,/ Këtu fillova./ Në auditorët e saj,/ Fëmijët antifashist,/ Zbritën nga malet,/ Triumfalisht!/ Bijtë e dëshmorëve,/ Në luftë rënë/ Mbetur jetim, Pa babë e nënë./ Bijtë e fshatarëve,/ Bijtë e punëtorëve,/ Ti shkollë i rrite,/ Ti i edukove./ Atdhetarë të zjarrtë,/ Për shtet e Atdhe,/ 45 vjet,/ Shqipërisë i dhe!/ Thellë në zemra,/ Shkolla jeton,/ Nuk mund të harrohet,/ Legjendë shkolla jonë./ E them me krenari,/ E kam për nder,/ Jam skënderbegas,/ Si atëherë!//



Tingujt e borisë,/ Më zgjojnë në mëngjes,/ Me vrap në gjimnastikë/ Zhveshur gjer në brez./ Bëj rreshtore,/ Me top luaj,/ Mësoj rregullore,/ Dhe gjuhë të huaj./ Mësoj fizikë,/ Kimi e histori,/ Muzikë, matematikë,/ Vizatim, letërsi./ Këngë patriotike, / Për ditë këndoj,/ Në opera, kinema,/ Me shokët shkoj./ Hyj në mësim,/ Me mësuese Dhuratën,/ Një ditë hartimi im,/ Mahniti klasën./ Ishte një shkëndijë,/ Që vlonte ne deje,/ Prirja për të shkruar,/ Mbeti brenda meje./ Mësues të nderuar,/ Kë të kujtoj më parë,/ Të pa harruar,/ Emrat në altar./ Na dhatë dije,/ Më të mirën edukatë,/ Për djem Shqipërie,/ 24 karat./ Ndjesë për prapësitë,/ Se edhe kemi bërë./ Ne çapkën të lindur,/ Ju zemër gjerë./ Mirënjohje pa fund,/ Në memorie mbetët./ Si ju e ajo shkollë,/ Nuk kishte tjetër!/ *** Skënderbegas,/ çdo gjë me kuptim./ E bukur uniforma,/ Si moshë në shpërthim./ Po ylli në ballë,/ Sa lezet të ka?/ Ishte simbol,/ Për punë të mëdha!/ Miq skënderbegas,/ Rrënjët atje kemi./ Të shkollës Skënderbej,/ Të fidanishtes jemi!/ Krenar për emrin,/ Për rrugën krenar./ 35 000,/ Armatë me luftëtar!/ Ne kemi një emër,/ Që prindërit na vunë/ Kemi krye emër,/ Që nuk vdes kurrë./ Shkolla ‘Skënderbej’,/ Fidanishte për ushtri./ Për kombin vlerë,/ Nder e krenari./ Sa personalitete,/ Vendit i dhe./ Në çdo fushë të jetës,/ Fidanishte je./ Elitë intelektuale,/ Kuptim i dhatë jetës./ Ju miq të mirë,/ Bënit diferencën./ Begsit komandantë,/ Begsit komisarë,/ Lum kush i ka njohur,/ Lum kush i ka parë!/ Begsit artiljerë,/ Të rrallë shenjëtarë,/ Drejt’ në objektiv,/ Me predhën e parë./ Begsit tankist,/ Oshtima në luginë./ U ndjek

këmbësoria,/ Në sulm vetëtimë./ Begsit aviator,/ Kundërajror e detar,/ Sy mprehtë,/ Në vijën e parë./ Begsit sportistë,/ Shkrimtar e artistë./ Mjeshtro të vërtetë,/ Profesionistë./ Begsit gjeneralë,/ Ministra, deputetë./ Shtetar të mirë,/ Lider të vërtetë!// *** Thuaj skënderbegas,/ Me zërin plot./ Shqiponjë ke thënë,/ Moj Shqipëri nënë./ Thuaj skënderbegas,/ Përjetësi ke thënë./ Zemër shqiptare,/ Krenari kombëtare./ Thuaj skënderbegas,/ Ke thënë lavdi./ Ke thënë siguri,/ Ke thënë liri./ Thuaj skënderbegas,/ Me zërin e fortë./ Ke dhënë kushtrim,/ O miku im./ Shkruaj për ty,/ Vëlla skënderbegas./ Nuk pushoj dot,/ Zemra mi thotë!/ Se ti ndrin,/ Me emrin tënd./ Kudo që je,/ Mbi dhe e nën dhe!// Më shumë se është shkruar,/ Do shkruhet për ty./ Brezat do tregojnë,/ Nuk do të harrojnë./ Nuk harrohet ajo shkollë./ Institucion strategjik./ Mësonjtore e rrallë,/ Për djem atdhetarë. ****/ Portë e dashur,/ E shkollës time,/ Portë e florinjit,/ Mbushur me kujtime!/ Mbylljen tënde,/ Kush firmosi,/ Harrimin e tij./ Turpin vulosi./ Mendimet bredhin,/ Herë si amanet,/ Herë si dëshirë./ Veç për mirë./ Sikur shkolla legjendë,/ Që bëri histori./ Lart të vlerësohet,/ Përjetsisht të nderohet./ Dëshirë e dëshirave,/ E parandjej./ “Nderi i Kombit”/ Shkolla Skënderbej!// ***/ Njomështak isha,/ Kur u veshë i blertë./ Trembëdhjet vite mbi supe kisha,/ Skënderbegas mbeta për jetë!/ Kur të mos jem në jetë,/ Dhe në se më kujtoni,/ Ishte skënderbegas,/ Zëplot’ ta thoni!// Tek pllaka e rrafshët,/ Që vihet mbi kokë,/ Skënderbegas 1962-1966,k/ Më vini o shokë!/ Nuk dua lule,/ As fjalim./ Emri skënderbegas,/Të ndrisë mbi varrin tim!”

Miratohet programi i përbashkët i huadhënies SAFE për mbrojtjen

Këshilli European ka miratuar një rregullore që krijon instrumentin e Veprimit të Sigurisë për Evropën (SAFE). SAFE është një instrument i ri financiar i BE-së që do të mbështesë ato shtete anëtare që dëshirojnë të investojnë në prodhimin industrial të mbrojtjes përmes prokurimit të përbashkët, duke u përqendruar në aftësitë prioritare.

SAFE do të financojë investime urgjente dhe në shkallë të gjerë në bazën teknologjike dhe industriale të mbrojtjes evropiane (EDTIB). Qëllimi është të rritet kapaciteti i prodhimit, duke u siguruar që pajisjet e mbrojtjes të jenë të disponueshme kur të nevojiten dhe të adresohen boshllëqet ekzistuese të aftësive - duke forcuar në fund të fundit gatishmërinë e përgjithshme mbrojtëse të BE-së.

Për më tepër, SAFE do t'i lejojë BE-së të mbështesë më tej Ukrainën duke e lidhur industrinë e saj të mbrojtjes me instrumentin që nga fillimi.

Megjithatë kjo u realizua pasi anashkaloi Parlamentin Evropian gjatë rrugës.

Miratimi i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme shënoi hapin e fundit të një procesi të diskutueshëm miratimi për programin e përbashkët të huadhënies prej 150 miliardë eurosh, të quajtur Veprimi i Sigurisë për Evropën (SAFE). Në prill, Komisioni Evropian përdori një klauzolë emergjence për të anashkaluar Parlamentin, që do të thotë se negociatat mbi tekstin përfundimtar të SAFE shkuan direkt në Këshill. Hungaria abstenoj në votimin e Këshillit për programin.

Programi SAFE u propozua fillimisht nga Komisioni në mars si pjesa e financimit të planit të tyre më të gjerë për të nxitur industrinë evropiane të mbrojtjes dhe për të rritur prodhimin e pajisjeve dhe municioneve ushtarake.

Të paktën tre vende duhet të bashkohen në kërkesat për financim nga programi SAFE për projektet e mbrojtjes, sipas tekstit. Projektet mund të përfshijnë gjithçka, nga porositë për municione dhe raketa, dronë ushtarakë ose pajisje elektronike të luftimit.

Ukraina dhe Norvegjia përfshihen gjithashtu në programin SAFE, dhe teksti përfundimtar krijon gjithashtu një mekanizëm për vende të tjera të jashtme - siç është Mbretëria e Bashkuar - që t'i bashkohen skemës duke negociuar marrëveshje me Komisionin.

Përmes këtyre projekteve, Komisioni synon të plotësojë boshllëqet e aftësive dhe të zvogëlojë varësinë e Evropës nga pajisjet ushtarake të prodhuara diku tjetër në botë - veçanërisht në Shtetet e Bashkuara.

Një betejë ligjore në prag?

Vendimi i Komisionit për të anashkaluar Parlamentin shkaktoi një reagim të zemëruar, me Presidenten e Parlamentit Roberta Metsola, e cila kërcënoi të çonte Këshillin në gjykatë në një letër drejtuar Komisionit dhe Presidencës së Këshillit në fillim të këtij muaji.

Ligjvënësit e BE-së mbështetën unanimisht një opinion ligjor me votim të fshehtë në prill që hodhi poshtë lëvizjen e Komisionit për të anashkaluar Parlamentin.

Sipas opinionit ligjor, të parë nga Euractiv, Parlamenti sugjeroi ndarjen e planit SAFE në dy pjesë. E para do të përfshinte huamarrjen dhe huadhënien sipas procedurës së emergjencës, ndërsa elementët industrialë të planit do të ecnin përpara sipas procedurës së zakonshme.

Zëdhënësjja e Komisionit, Paula Pinho, nuk mundi të thoshte të martën nëse Metsola-s i është dërguar një përgjigje zyrtare, por pohoi se vendimi i Komisionit ishte i justifikuar në këto rrethana. Euractiv mësoi më parë se, që nga nata e së hënës, Metsola nuk kishte marrë ende një përgjigje.

Tani që Këshilli miratoi propozimin SAFE, Parlamenti do të ketë afërsisht dy muaj për të paraqitur një ankesë ligjore, dhe gjykata e lartë e BE-së do të ketë dy vjet për të nxjerrë një vendim.

Sipas tekstit përfundimtar të programit SAFE, vendet do të kenë gjashtë muaj kohë për të hartuar propozime të përbashkëta për prokurim, për të renditur partnerët e industrisë së mbrojtjes dhe për të kërkuar kredi nga Komisioni Evropian. Komisioneri i Mbrojtjes Andrius Kubilius tha javën e kaluar se kërkesat përfundimtare do të dorëzohen në nëntor.

Vendet e treta që shpresojnë të bashkohen me skemën SAFE dhe të marrin pjesë në projekte të përbashkëta ka të ngjarë të duhet gjithashtu të finalizojnë një marrëveshje dypalëshe me Komisionin gjatë asaj periudhe.



Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Keir Starmer, nënshkroi së fundmi një Partneritet për Siguri dhe Mbrojtje me BE-në, një hap i parë i nevojshëm drejt dhënies së aksesit të kompanive britanike të mbrojtjes në programin SAFE prej 150 miliardë eurosh. Zyrtarët e Mbretërisë së Bashkuar thanë se shpresonin të nënshkruanin një marrëveshje të dytë dypalëshe me BE-në “brenda disa javësh”.

Financimi nga programi SAFE do t'u dërgohet vendeve pjesëmarrëse në formën e kredive 45-vjeçare nga Komisioni.

Pasi propozimet e vendeve të jenë shqyrtuar nga Komisioni, Këshilli do të ketë afat deri më 30 qershor 2027, për t'i miratuar ato, sipas tekstit të parë nga Euractiv.

Pasi Këshilli të ketë miratuar marrëveshjen, vendet mund të fillojnë të paraqesin kërkesa për pagesa te Komisioni, i cili do t'i drejtohet tregjeve të kapitalit për të marrë hua 150 miliardë euro. Shpërndarja e kredisë nga Komisioni për vendet pjesëmarrëse do të bëhet deri më 30 dhjetor 2030.

Veprim i pranueshëm

Aktivitetet e pranueshme të financuara përmes SAFE do të lidhen me listën e parë të fushave prioritare të identifikuara nga Këshilli Evropian më 6 mars 2025 dhe do të ndahen në dy kategori produktesh mbrojtëse:

1) Municione dhe raketa; sisteme artilerie, duke përfshirë aftësitë e goditjeve me precizion të thellë; aftësi luftarake tokësore dhe sistemet e tyre mbështetëse, duke përfshirë pajisjet e ushtarëve dhe armët e këmbësorisë; mbrojtja e infrastrukturës kritike; kibernetika; lëvizshmëria ushtarake duke përfshirë kundërlëvizshmërinë;

2) Sisteme mbrojtëse ajrore dhe raketore; aftësi detare sipërfaqësore dhe nënujore; dronë dhe sisteme anti-dronë; mundësues strategjikë, të tillë si, por pa u kufizuar në, transporti strategjik ajror, furnizimi me karburant ajër-ajër dhe sistemet C4ISTAR, si dhe asetet dhe shërbimet hapësinore; mbrojtja e asetëve hapësinore; intelijenca artificiale dhe lufta elektronike.

Produktet e mbrojtjes që i përkasin kategorisë 2 do t'i nënshtrohen kushteve më të rrepta të pranueshmërisë, duke kërkuar

që kontraktorët të kenë aftësinë për të vendosur për përkufizimin, përshtatjen dhe evolucionin e dizajnit të produktit mbrojtës të prokuruar.

Për të dyja kategoritë e produkteve, kontratat e prokurimit do të duhet të sigurojnë që kostoja e komponentëve me origjinë jashtë BE-së, shteteve EEA-EFTA dhe Ukrainës nuk është më e lartë se 35% e kostos së vlerësuar të komponentëve të produktit përfundimtar.

BE-ja është e angazhuar për forcimin dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe angazhimit transatlantik në sigurinë dhe mbrojtjen, si dhe plotësueshmërinë me NATO-n. Në këtë sfond, SAFE do të përpiqet të rrisë ndërveprimin, të vazhdojë bashkëpunimin industrial dhe të sigurojë akses reciprok në teknologjitë më të fundit me partnerë të besuar.

SAFE do të hyjë në fuqi ditën pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, pra më 29 maj 2025.

Në përfundimet e tij të 6 marsit 2025, Këshilli Evropian theksoi se Evropa duhet të bëhet më sovranë dhe më përgjegjëse për mbrojtjen e saj dhe më e pajisur për të vepruar dhe për t'u marrë në mënyrë autonome për t'u përballur me sfidat dhe kërcënimet e menjëhershme dhe të ardhshme. Në atë Këshill Evropian, të gjitha shtetet anëtare u zotuan të forcojnë gatishmërinë e tyre të përgjithshme mbrojtëse, duke zvogëluar varësitë strategjike, duke adresuar boshllëqet kritike të aftësive dhe duke forcuar EDTIB-në në përputhje me rrethanat, në mënyrë që BE-ja të jetë në gjendje të furnizojë më mirë pajisje në sasi dhe me ritmin e përsheptuar të nevojshëm.

SAFE është shtylla e parë e Planit/Gatishmërisë së Komisionit Evropian për Riarmimin e Evropës 2030, i cili propozon të shfrytëzojë mbi 800 miliardë euro në shpenzime për mbrojtje. Shtyllat e tjera janë: rritja e financimit kombëtar të mbrojtjes duke aktivizuar klauzolën kombëtare të shpëtimit të Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes; bërja e instrumenteve të BE-së, siç janë fondet e kohezionit, më fleksibël për të lejuar investime më të mëdha në mbrojtje; plotësimi i financimit publik me kontribute nga Banka Evropiane e Investimeve; dhe mobilizimi i kapitalit privat.

Peizazhi në zhvillim i strategjisë ushtarake, zhvillimi teknologjik

Në mjedisin e sotëm të sigurisë globale që ndryshon me shpejtësi, strategjia ushtarake po përshtatet për t'u përballur me kërcënimet në zhvillim, tensionet gjeopolitike dhe inovacionet teknologjike. Kombet po përqendrohen në frenim, modernizim dhe partneritete strategjike për të siguruar superioritet mbrojtës.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes e SHBA-së, një ndryshim në prioritetet

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes (NDS) 2025 përshkruan një ndryshim të rëndësishëm në prioritetet ushtarake të SHBA-së. Një theks gjithnjë e më i madh po vihet në mbrojtjen e atdheut, frenimin strategjik dhe ruajtjen e një avantazhi konkurrues kundër Kinës në Indo-Paqësor. Strategjia integron mësimet e nxjerra nga konfliktet në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme, duke i dhënë përparësi aftësive të reagimit të shpejtë dhe mbështetjes aleate.

Prania ushtarake në rritje e Kinës në Detin e Kinës Jugore dhe zgjerimi i aftësive bërthamore, kanë bërë që SHBA-të të përforcojnë angazhimet mbrojtëse me aleatët rajonalë. Stërvitjet e përbashkëta ushtarake, vendosjet strategjike të raketave dhe koordinimi i mbrojtjes kibernetike janë rritur për të kundërshtuar agresionin e mundshëm.

Ndarja e Barrës me Aleatët

SHBA-të po inkurajojnë shpenzime më të mëdha ushtarake midis partnerëve të NATO-s dhe aleatëve të Indo-Paqësorit për të forcuar masat kolektive të sigurisë. Një aspekt kyç përfshin pajisjen e forcave aleate me sisteme të avancuara të mbrojtjes nga raketat, aftësi të luftës kibernetike dhe teknologji autonome mbikëqyrjeje.

Ristrukturimi i Ushtrisë Amerikane - Modernizimi i Aseteve Ushtarake

Përpjekjet e ristrukturimit të Ushtrisë Amerikane synojnë kalimin nga platformat tradicionale të luftimit tokësor në aftësi goditjesh precize, njësi autonome luftarake dhe rrjete të integruara të fushës së betejës. Programet e përqendruara më parë në zhvillimin e automjeteve të blinduara po rialokohen drejt sistemeve të raketave me rreze të gjatë veprimi.

Robotika dhe Inteligenca Artificiale në Luftë

Përparimet e fundit në automjetet luftarake robotike dhe sistemet e zbulimit të mundësuar nga Inteligenca Artificiale kanë riformësuar strategjinë e fushës së betejës. Sistemet autonome po zhvillohen për të ndihmuar operacionet e këmbësorisë, për të minimizuar viktimat dhe për të ofruar analiza të inteligjencës në kohë reale për vendimmarrje më të shpejtë.

Rregullimet e Programit të Tankeve të Lehta

Ushtria ka rregulluar strukturën e forcës së saj të blinduar, duke ndërprerë disa programe të tilla si tanku i lehtë M10 "Booker" në favor të platformave të përmirësuara të luftës me dronë dhe sistemeve të përparuara të raketave të afta për synime me saktësi të lartë.

Ukraina dhe Rusia: Ndryshime Strategjike - Ndikimi i ndihmës ushtarake amerikane

Me qasje në sisteme raketash me rreze të gjatë veprimi amerikane, strategjia ushtarake e Ukrainës ka evoluar për t'i dhënë prioritet operacionet e goditjeve të thella që synojnë qendrat e komandës ruse dhe qendrat logjistike. Këto armë kanë përmirësuar aftësinë e Ukrainës për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive përparimeve ruse.

Taktikat jo konvencionale të Rusisë

Rusia ka përshtatur strategjinë e saj, duke vendosur operacione përmbytjeje dhe taktika të luftës elektronike për të prishur lëvizjet ushtarake ukrainase. Duke manipuluar terrenin dhe infrastrukturën, Rusia synon të pengojë përparimet ukrainase dhe të ndërlikojë logistikën.

Pasojat Globale

Konflikti i vazhdueshëm ka riformësuar qëndrimin mbrojtës të NATO-s, duke çuar në rritjen e vendosjes së trupave në Evropën Lindore dhe në përforsimin e sistemeve të mbrojtjes nga raketat pranë kufijve të Rusisë. Efekti i valëzuar gjeopolitik po ndikon në aleancat ushtarake në të gjithë botën.

Roli i teknologjive në zhvillim - Lufta e mundësuar nga AI

AI-ja po integrohet gjithnjë e më shumë në planifikimin ushtarak, duke mundësuar identifikimin autonom të objektivave, analizat parashikuese për lëvizjet e trupave dhe simulimet e luftimit të drejtuara nga AI-ja. Megjithatë, shqetësimet etike në lidhje me vendosjen autonome të armëve mbeten një debat qendror në diskutimet globale të sigurisë. Aftësitë e dronëve dhe pyetjet etike.

Zgjerimi i luftës me dronë ka ngritur pyetje në lidhje me llogaridhënien dhe etikën e luftimit. Ndërsa dronët ofrojnë sulme me precizion të lartë dhe inteligjencë në kohë reale, shqetësimet për viktimat civile dhe përshkallëzimin e paqëllimshëm vazhdojnë.

Lufta Kibernetike: Një fushëbeteje e re

Kërcënimet e sigurisë kibernetike tani janë një element thelbësor

i strategjisë së mbrojtjes, me kombet që investojnë shumë në njësitë e mbrojtjes kibernetike për të mbrojtur infrastrukturën kritike, rrjetet financiare dhe qendrat e komandës ushtarake nga sulmet e mundshme kibernetike.

Peizazhi i strategjisë ushtarake në vitin 2025 pasqyron mbështetjen në rritje në inovacionin teknologjik, manovrimin gjeopolitik dhe planifikimin adaptiv të mbrojtjes. Ndërsa tensionet globale evoluojnë, kombet duhet të lundrojnë në modernizim me konsiderata etike, duke siguruar sigurinë afatgjatë duke ruajtur stabilitetin në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Shembuj të përdorimit të inteligjencës artificiale në luftë

AI po i jep formë gjithnjë e më shumë luftës moderne, me aplikime që variojnë nga dronët autonomë deri te sistemet e mbrojtjes kibernetike. Ja disa shembuj të dukshëm:

- Dronë Autonome: Dronët e mundësuar nga AI, si "Harop" dhe "Heron" i Indisë, mund të bredhin mbi fushat e betejës, të identifikojnë objektivat dhe të godasin me precizion. Ukraina ka përdorur gjithashtu dronë sulmi FPV të udhëhequr nga IA për t'iu kundërvënë forcave ruse.

- Mbikëqyrje e Drejtuar nga AI: Algoritme të përparuara, si "Gospel" dhe "Lavender" i Izraelit, analizojnë të dhënat e inteligjencës në kohë reale për të sugjeruar objektiva. Njohja e fytyrës e mundësuar nga AI përdoret gjithashtu për të identifikuar kriminelët e luftës.

- Lufta Kibernetike: AI përmirëson mbrojtjen kibernetike duke zbuluar dhe neutralizuar kërcënimet para se ato të përshkallëzohen. Analiza e ndjenjës e drejtuar nga AI është përdorur për të manipuluar perceptimin publik në konflikte, siç është skenari i luftës njohëse Indi-Pakistan.

- Armët Autonome Vdekjeprurëse (LAW): Armët e kontrolluara nga AI mund të identifikojnë dhe të angazhojnë objektiva pa ndërhyrjen njerëzore. Një dron Kargu-2 i prodhuar në Turqi mund të ketë ndjekur në mënyrë autonome luftëtarë në Libi, duke shënuar një nga rastet e para të sulmeve vdekjeprurëse të drejtuara nga AI. - Mirëmbajtja Parashikuese: AI ndihmon forcat ushtarake të mirëmbajnë pajisjet duke parashikuar dështimet para se të ndodhin. Programi CBM+ i Forcave Ajrore të SHBA-së përdor AI-në për të monitoruar avionët luftarakë F-35, duke zvogëluar kohën e ndërprerjes dhe duke përmirësuar gatishmërinë.

- Vendimmarrja e Ndihmuar nga AI-ja: Sistemet e AI-së analizojnë të dhënat e fushës së betejës për të ndihmuar komandantët në marrjen e vendimeve strategjike. Doktrina ushtarake e Kinës përmend në mënyrë të qartë "luftën e inteligjencës", duke theksuar strategjitë e luftimit të drejtuara nga AI-ja.

Këto shembuj nxjerrin në pah rolin në rritje të AI-së në luftë, duke ngritur shqetësimet etike në lidhje me llogaridhënien dhe

përshkallëzimin e paqëllimshëm.

Dronët autonomë po revolucionarizojnë luftën moderne duke përmirësuar mbikëqyrjen, sulmet precize dhe koordinimin e fushëbetejës. Ja një vështrim më i thellë mbi rolin e tyre:

Synimi dhe Vendimmarrja e Mundësuar nga AI-ja

Dronët autonomë përdorin algoritme të inteligjencës artificiale (AI) për të identifikuar dhe angazhuar objektiva pa kontroll të drejtpërdrejtë njerëzor. Për shembull, dronët "Harop" dhe "Heron" të Indisë mund të bredhin mbi fushat e betejës, të analizojnë pozicionet e armikut dhe të godasin me precizion. Në mënyrë të ngjashme, Ukraina ka vendosur dronë sulmi FPV, të udhëhequr nga AI, për t'iu kundërvënë forcave ruse.

Teknologjia e Dronëve Swarm

Dronët Swarm veprojnë në grupe të koordinuara, duke komunikuar me njëri-tjetrin për të ekzekutuar misione komplekse. Këta dronë mund të mposhtin mbrojtjen e armikut, të kryejnë zbulim dhe madje të nisin sulme të sinkronizuara. Ushtria amerikane dhe Kina po zhvillojnë në mënyrë aktive aftësi të dronëve Swarm për të rritur efikasitetin e fushëbetejës.

Armët Autonome Vdekjeprurëse (LAW)

Disa dronë autonomë klasifikohen si Sisteme Autonome të Armëve Vdekjeprurëse (LAWS), që do të thotë se ata mund të angazhojnë objektiva pa ndërhyrjen njerëzore. Një dron "Kargu-2" i prodhuar në Turqi mund të ketë gjuajtur në mënyrë autonome luftëtarë në Libi, duke shënuar një nga rastet e para të sulmeve vdekjeprurëse të drejtuara nga AI. Kjo ngre shqetësimet etike në lidhje me llogaridhënien dhe përshkallëzimin e paqëllimshëm.

Integrimi i Luftës Kibernetike dhe Elektronike

Dronët autonomë po integrohen gjithnjë e më shumë në strategjitë e luftës kibernetike dhe elektronike. Për shembull, dronët StormShroud të Mbretërisë së Bashkuar mund të blikojnë radarët e armikut, duke mbrojtur avionët luftarakë të pilotuar nga zbulimi. Përveç kësaj, dronët e drejtuar nga AI përdoren për zbulim kibernetik, duke mbledhur inteligjencë në rrjetet e armikut.

Sfidat etike dhe ligjore

Rritja e dronëve autonomë ka shkaktuar debate mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare. Armët e drejtuara nga AI nuk kanë gjykim njerëzor, duke rritur rrezikun e identifikimit të gabuar të civilëve si luftëtarë. Kombet e Bashkuara kanë bërë thirrje për rregullore për të parandaluar luftën e pakontrolluar të AI-së.

Dronët autonomë po riformësojnë strategjinë ushtarake, duke ofruar saktësi, efikasitet dhe përshtatshmëri të paparë. Megjithatë, vendosja e tyre ngre shqetësimet etike që kërkojnë rregullim të kujdesshëm. Ndërsa teknologjia e AI-së përparon, kombet duhet të balancojnë inovacionin me praktikën e përgjegjshme të luftës.



HISTORIA E NJË LIBRI PËR USHTRINË NACIONALÇLIRIMTARE SHQIPTARE



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Nisja e një libri për historinë e ushtrisë në luftë...

Profesor Proletar Hasani e nisi librin në vitet tetëdhjetë të shek. XX, me temën për doktoraturë “Organizimi ushtarak i forcave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare (UNÇSH), 1939-1944”, të mbrojtur në fundin e vitit 1989, në Akademinë e Mbrojtjes (sot Akademia e Forcave të Armatosura). Ndërsa në fundin e vitit 1999, pa dritën e botimit si libër me titull “Histori e Pashkruar”.

Libri i kushtohet organizimit, ecures, rritjes dhe shndërrimit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare në ushtri të rregullt. Kjo ushtri u bë forca e armatosur e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kryesore në luftën kundër pushtuesve fashistë të Shqipërisë.

Ajo i hodhi hapat e para të organizimit me njësite guerile dhe çeta, me batalione dhe, më 10 korrik 1943, me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë. Ushtria Partizane u rrit dhe u fuqizua me formacione të përmasave të mëdha, si brigadë, divizion dhe korparmatë që çoi në fund misionin e saj, çlirimin e plotë të Shqipërisë nga pushtuesit e huaj fashistë.

Pas 25 viteve, botimi i tij me titull “Në rrjedhat e luftës...” është tërësisht një ripunim dhe ribotim me qëllim, plotësimin dhe pasurimin e me dokumente, me studime e botime të reja të shumta, vendase e të huaja, të hulumtuara dhe publikuara që nga koha e botimit të parë. Në këtë botim të ri, libri ka pësuar një ndryshim strukturor, është pajisur me ilustrime grafike, me foto etj., të cilat i japin një realizëm dhe vërtetësi shkencore, si dhe e bëjnë më të kuptueshëm për lexuesin. Libri i profesor Proletar Hasanit ka përmirësuar dhe disa mangësi nga botimet e para, por është një botim në shërbim të historisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të historisë ushtarake shqiptare.

Dimensionet e rëndësishme të luftës

Dihet se Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, u organizua dhe u zhvillua në kontekstin e Luftës së Dytë Botërore, 1939-1945, kundër pushtuesve fashistë të Shqipërisë. Kjo luftë, siç argumenton profesori, është padyshim “një nga më të mëdhatë, më të organizuarat dhe të rëndësishmet në historinë e popullit shqiptar”.

Libri qartëson periudhën historike në të cilën u zhvillua lufta, mënyrat e organizimit, përmasat, pjesëmarrësit, arritjet e rëndësishme dhe vendimtare, përfundime për popullin shqiptar dhe Shqipërinë. Kjo Luftë Antifashiste shpuri në çlirimin e plotë të Shqipërisë nga pushtuesit fashistë, i riktheu lirinë dhe pavarësinë, sovranitetin dhe identitetin e nëpërkëmbur dhe të humbur nga pushtuesit fashist. Lufta u vlerësua, u njoh dhe u mbështet nga Aleatët e Koalicionit të Madh Antifashist Botëror, në dhjetor 1942 dhe deri në përfundimin, më 29 Nëntor 1944.


Lufta e rreshtoi Shqipërinë dhe popullin shqiptar në anën e fituesve të Luftës së Dytë Botërore, 1939-1945. Kështu Shqipëria, me rezistencën antifashiste ruajti tërësinë tokësore nga synimet e vjetra aneksioniste të fqinjëve ballkanas. Autori thekson se arritjet e kësaj lufte janë dhe arsye për të qenë krenarë, në ndihmesën e dhënë për mposhtjen e fashizmit, e keqja më e madhe e kohës.

Autori argumenton shkencërisht se lufta e popullit shqiptar ishte antifashiste dhe nacionalçlirimtare.

Këtë luftë e “organizoi dhe e udhëhoqi Fronti Nacionalçlirimtar, ku Partia Komuniste e Shqipërisë pati një rol e një peshë të konsiderueshme”. Lufta përbënte dhe një veçori, se Shqipëria ishte nga vendet e pakta që u çliruan me luftën e formacioneve luftarake të popullit shqiptar. Është një e vërtetë e pamohueshme se në luftën për çlirimin e Shqipërisë, nuk erdhi dhe nuk veproi asnjë force ushtarake e vendeve aleate. Lufta e popullit shqiptar u mbështet nga disa misione ushtarake të dërguara nga aleatët britanikë, amerikanë dhe, në prag të përfundimit të luftës, në gusht 1944, dhe një mision i vogël sovjetik.

Profesori thekson se LANÇ është çmuar si një ndër ngjarjet e mëdha të historisë së popullit shqiptar, për arritjet e saj me rëndësi strategjike, që lidhen me fatet dhe ekzistencën e Shqipërisë.

Në këtë luftë të pabarabartë, populli i vogël shqiptar, luftoi dhe bëri sakrificë që i kapërcenin mundësitë e tij, në çdo pikëpamje. Por, lufta, ndihmesa, sakrificat dhe dëmet njerëzore e materiale të pësura gjatë Luftës së Dytë Botërore, janë vlerësuar shumë nga Aleatët e Koalicionit të Madh Antifashist Botëror dhe gjithë



bota demokratike. Përtej vlerave dhe arritjeve të karakterit politik, ekonomik dhe ndërkombëtar, Lufta Antifashiste NÇ në Shqipëri pati edhe një dimension po aq të rëndësishëm, pa të cilin ajo nuk mund të zhvillohej dhe, aq më pak të fitohej.

Dimensioni i Artit Ushtarak

Dimensioni i Artit Ushtarak në luftë, në thelb, ka të bëjë me tiparet, karakterin, veçoritë dhe përmbajtjen e formave dhe mënyrave e zhvillimit të kësaj lufte. Arti i Luftës u shfaq në tiparet, dukuritë dhe veçoritë e organizimit ushtarak, armatosjen, drejtimin, taktikën dhe shpirtin luftarak të formacioneve të armatosura, të krijuar nga forcat politike (partitë), që dolën në skenën politike shqiptare të viteve të LANÇ-it. Situata kërkonte mobilizimin dhe ngritjen e forcave të armatosura, të cilat mund të organizonin dhe zhvillonin luftën antifashiste për çlirimin e Shqipërisë dhe rikthimin e pavarësisë së saj. Fillimet e krijimit të këtyre forcave të armatosura qenë spontane, që aty nga fillimi i vitit 1940, kohë kur në zona të veçuara të vendit, u shfaqën disa çeta të vogla të armatosura nacionaliste, ende pa ngjyrimet politike. Veçanërisht e rëndësishme dhe e domosdoshme, po aq sa dhe i dukshëm bëhej krijimi i këtyre forcave, sidomos me daljen në skenën politike shqiptare i partive të reja politike, të cilat do të konkretizonin dhe përshpejtonin krijimin dhe daljen në teatrin shqiptar të luftës e forcave të armatosura antifashiste.

Forca e parë në skenën politike shqiptare ishte Partia Komuniste Shqiptare (PKSH), e themeluar më 8 nëntor 1941. Në program kjo parti përcaktoi dy detyra kryesore, që ishin “... çlirimi i vendit nga pushtuesit fashistë dhe rivendosja e pavarësisë kombëtare të atdheut, si dhe rindërtimi i një rendi demokratik në Shqipëri. Ato do të arriheshin përmes bashkimit të të gjithë popullit pa dallim, në një front antifashist dhe organizimit të kryengritjes së armatosur”. Realizimin e këtij programi, PKSH e shihte “...në bashkëpunim me forcat atdhetare në vend dhe, rrafsh ndërkombëtar, natyrisht me vendet e Antifashiste Botërore, në radhë të parë me popujt fqinjë të Ballkanit”.

Kryengritja e Armatosur filloi me formimin e formacioneve të vogla të armatosura, njësitet guerile me pak anëtarë, me çetat partizane dhe, më tej, të vijonte me procesin e krijimit të formacioneve dhe njësiteve më të mëdha, të organizimit drejtues qendror ushtarak, si Shtabi i Përgjithshëm dhe Ushtrisë NÇ të rregullt. Në prag të Konferencës pluraliste të Pezës, të mbajtur më 16 shtator 1942, krahas njësiteve guerile të Lëvizjes NÇ, të udhëhequra nga PKSH, në disa zona të Shqipërisë qenë formuar dhe vepronin disa çeta të armatosura, tërësisht nacionaliste. Qëllimi themelor dhe thelbësor politik i Mbledhjes së Pezës ishte “...bashkimi i popullit, pa dallim, në një front të përbashkët

lufte kundër pushtuesit”. Ky bashkim synohej të realizohej “...pa dallim klase dhe bindjeje politike”.

Organizata e Ballit Kombëtar lindi si alternativë e forcave të djathta për zgjidhjen e problemeve që shqetësonin shoqërinë shqiptare nën pushtimin fashist, ngriti gjithashtu edhe strukturat e veta ushtarake, nga çetat deri tek grupet balliste. Forca e tretë politike, që u shfaq në skenën politike në Shqipëri ishte Lëvizja e Legalitetit. Ato u organizuan në një numër të kufizuar formacionesh luftarake të nivelit të vogël taktik, kryesisht në bazë çetash të armatosura, të cilat si zona të qëndrimit, mbështetjes dhe veprimtarisë së tyre kishin kryesisht disa territore në Shqipërinë e Mesme. Ndërkohë, në zonën verilindore të Shqipërisë vepronin dhe forca të organizuara në mënyrë të mëvetësuar, nga disa prijës nacionalistë të njohur.

Ndërmjet këtyre partive shqiptare dhe forcave të armatosura të krijuara dhe të udhëhequra prej tyre, si dhe atyre të mëvetësuar nacionaliste të Veriut të Shqipërisë, Ushtria shqiptare, në rrjedhën e luftës, u rrit, u forcua dhe luftoi deri në çlirimin e plotë të vendit. Nga vetë karakteri vullnetar i saj, Ushtria NÇ ishte dhe mbeti forca më e mirëorganizuar, më e disiplinuar dhe më e vendosura në pikëpamje luftarake. Ushtria NÇ që nga koha e krijimit, luftoi me vendosmëri kundër trupave pushtuese fashiste italo-gjermane, duke e çuar luftën deri në fund, në çlirimin e vendit, më 29 Nëntor 1944. Ushtria NÇ, u rrit dhe u shndërrua në forcën më të madhe luftarake në vend, ku reflektonte tiparet dhe veçoritë organizative dhe luftarake të dallueshme në përjasje me dy forcat e tjera të armatosura, të Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, të cilat u shpërbënë dhe u shpërndanë mu në prag të përfundimit të LANÇ në Shqipëri.

Rreth përmbajtjes së librit

Prof. Proletar Hasani librin “Në rrjedhat e luftës...” e fillon me një hyrje të gjatë për agresionin fashist dhe pushtimin e Shqipërisë. Strukturën e librit profesori e ka ndarë në pesë pjesë, ku çdo pjesë është e përbërë nga disa kapituj.

Pjesa e parë trajton organizimin e rezistencës së armatosur, lëvizjen antifashiste, shfaqjen e njësiteve guerile, Konferenca pluraliste e Pezës, njohja e rezistencës antifashiste shqiptare nga Aleatët e Mëdhenj të Koalicionit Antifashist Botëror, fillimi i krijimit të çetave të armatosura antifashiste dhe i çetave partizane, çetat vullnetare - territoriale, formacioni luftarak i batalionit partizan.

Pjesa e dytë i kushtohet krijimit të Shtabit të Përgjithshëm, formimi i grupit partizan, krijimi dhe organizimi i shtabit të qarkut dhe krijimi i brigadës sulmuese, si formacioni bazë i ushtrisë NÇSH, krijimi i Zonës së Parë Operative dhe i pushtetit ushtarak të prapavijave. Pjesa e tretë paraqet shndërrimin e UNÇSH-së në ushtri të rregullt maj-nëntor 1944, Kongresi i Përmetit dhe vendimet, formimi i formacioneve me përmasa të mëdha, operativo-strategjike, krijimi i Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë NÇ, divizioni sulmues, korparmata, njësia më e madhe e UNÇSH-së, vendosja e gradave ushtarake dhe roli i tyre.

Në pjesën e katërt zënë vend probleme si vështirimi mbi llojet e armëve dhe shërbimeve, intendenca, informativ (i zbulimit), shëndetësor, ndërlidhja, xhenio, artileria partizane, gjyqi ushtarak (partizan) etj. Ndërsa pjesa e pestë iu kushtohet tipareve dhe veçorive të organizimit të UNÇ-së, numri, moshë, emërtimin “partizan”, veshja, armatimi, simbole, parulla dhe shenja dalluese të ushtrisë NÇ, zgjidhja e problemit të drejtuesve dhe e stërvitjes të formacioneve partizane, vendi, roli dhe ndikimi i PKSH-së, rinia, morali dhe disiplina, formacionet partizane me ushtarakë të huaj, roli i misionëve ushtarake aleate etj.

Në libër autori me kujdes ka paraqitur dhe disa lidhje, pasqyra, skema, faksimile, të cilat e plotësojnë dukshëm këtë periudhë historike të ngritjes, organizimit dhe formatimit të një ushtrie të rregullt që çoi në çlirimin e vendit nga pushtuesit nazi-fashistë. Autori me korrektësi jep dhe një bibliografi të pasur në tërë faqet e librit.

Prof. Proletar Hasani në veprimtarinë e tij disavjeçare ka bërë këto botime kryesore: “Historia e artit ushtarak të popullit shqiptar gjatë Luftës Antifashiste NÇ 1939-1944”, 1989, (bashkautor); “Histori e Pashkruar”, 1999; “Kush e ka drejtuar Ushtrinë Shqiptare”, 2001; “Historia e Ushtrisë (nga Lashtësia-1945), 2008, (bashkautor); “Drejt Perëndimit”, 2011; “Me fytyrë nga Perëndimi” 2013, (bashkautor); “Histori Lidereship”, 2017, (bashkautor) dhe “Historia e Ushtrisë Shqiptare 1912-1939”, 2023 (bashkautor), në disa prej Historikëve të Brigadave Sulmuese të UNÇSH-së, ka qenë bashkautor dhe redaktor shkencor i tyre, si dhe në Fjalorin Enciklopedik Ushtarak Shqiptar.

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s (CMC) mori pjesë në Konferencën e 18-të të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit në Stamboll. Paraqitja e parë e Admiralit Giuseppe Cavo Dragone në këtë forum shënon edhe vizitën e tij të parë në Turqi.

Konferenca, e organizuar në Qendrën Shumëkombëshe të Luftës së Përbashkët (MJWC) nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm Turk, gjenerali Metin Gürak, përfshiu diskutime mbi mënyrat për të forcuar paqen, sigurinë dhe bashkëpunimin ushtarak. Ajo mbledhi Shefat e Shtabit të Përgjithshëm, autoritetet e larta dhe zyrtarët e lartë ushtarakë nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Serbia, Turqia, Kroacia dhe Sllovenia. Pjesëmarrësve iu drejtua zëvendës presidenti i Turqisë, Cevdet Yilmaz.

Në fjalën e tij, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s theksoi rëndësinë strategjike të Ballkanit dhe deklaroi: “Ky rajon vazhdon të jetë ndër prioritetet kryesore të NATO-s”. Ai gjithashtu theksoi përfitimet dhe nevojën për bashkëpunim të vazhdueshëm ushtarak midis vendeve të Ballkanit, duke theksuar se “dialogu mbi doktrinën, taktikat dhe madje edhe rrugët e prokurimit mund të ndihmojë në shmangien e dyfishimit dhe në nxitjen e ndërveprimit”.

Konferenca e këtij viti u përqendrua në “Vizionin për Përdorimin e Sistemeve pa Pilot në Mjedisin e Ardhshëm Operativ” dhe ishte një mundësi për të shkëmbyer pikëpamje mbi forcimin e bashkëpunimit ushtarak, si dhe mundësitë dhe sfidat që lidhen me sistemet pa pilot. Programi trajtoi zhvillimin e teknologjive autonome, mekanizmat e vendimmarrjes të mbështetura nga inteligjenca artificiale, bashkëpunimin njeri-makinë në fushën e betejës dhe aspektet teknologjike, strategjike dhe etike të sistemeve pa pilot.

Gjatë konferencës, Admirali Cavo Dragone zhvilloi gjithashtu disa takime dypalëshe për të diskutuar sfidat aktuale të sigurisë, përgatitjet për Samitin e NATO-s dhe Konferencën e ardhshme të Komitetit Ushtarak.

Që nga krijimi i saj në vitin 2007, Konferenca e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Vendeve të Ballkanit ka qenë një forum i rëndësishëm ushtarak rajonal, ku promovimi i bashkëpunimit, stabilitetit dhe besimit midis vendeve të Ballkanit ka qenë parësor. Ajo ka konfirmuar angazhimin e të gjithë anëtarëve për të ofruar përgjigje në kohë dhe efikase ndaj sfidave dhe kërcënimeve të ndryshme të sigurisë në rajon.

Konferenca e 18-të e Shefave të Mbrojtjes së Vendeve të Ballkanit, në Stamboll



NATO forcon bashkëpunimin me industrinë për të mbrojtur infrastrukturën kritike nënujore

Rrjeti i Infrastrukturës Kritike Nënujore të NATO-s u takua në Karlskrona, Suedi, duke bashkuar autoritetet civile dhe ushtarake, partnerët e industrisë dhe ekspertët nga e gjithë Aleanca për të thelluar bashkëpunimin në mbrojtjen e kabllove dhe tubacioneve që mbështesin lidhjen globale dhe sigurinë energjetike.

Takimi u përqendrua në rritjen e ndërgjegjësimit për situatën, forcimin e gatishmërisë dhe forcimin e përgjigjeve kolektive përmes përmirësimit të shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit. Pjesëmarrësit diskutuan qasje inovative për zbulimin e aktiviteteve të dyshimta dhe sigurimin e aseteve jetësore nënujore, duke përfshirë edhe përmes teknologjive të reja të ndjeshmërisë dhe monitorimit.

“Ndarja e informacionit në sektorët publik-privat dhe civil-ushtarak nuk është vetëm e dobishme, por është thelbësore”, tha Ambasadori Jean-Charles Ellermann-Kingombe, Ndihmës Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s për Inovacionin, Hibridin dhe Kibernetikën. “Rritja e aftësisë sonë për të penguar, zbuluar dhe reaguar ndaj kërcënimeve kërkon një përpjekje kolektive. Ne do të vazhdojmë punën tonë së bashku për të bërë pikërisht këtë”.

Pas ndërprerjeve në infrastrukturën nënujore në Detin Baltik në dhjetor 2024, NATO nisi “Baltic Sentry” – një aktivitet shumë-domenesh për të forcuar praninë ushtarake të Aleancës në rajon dhe për të përmirësuar aftësinë e saj për të zbuluar dhe reaguar ndaj kërcënimeve të mundshme.



NATO dhe Bashkimi Evropian bashkohen për Ukrainën në një takim NAC – PSC

Në Pallatin Egmont në Bruksel, Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e NATO-s, Radmila Shekerinska, së bashku me Kryetaren e Komitetit Politik dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian, Delphine Pronk, drejtuan një takim informal të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe Komitetit Politik dhe të Sigurisë, me fokus në Ukrainë. Morën pjesë edhe figura të larta politike dhe ushtarake, si dhe përfaqësues të çdo kombi aleat dhe shteti anëtar të BE-së.

NATO dhe Bashkimi Evropian kanë qenë prej kohësh partnerë të ngushtë dhe kanë interesa të shumta të përbashkëta sigurie. Pas pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia, Aleatët e NATO-s - shumë prej të cilëve janë gjithashtu shtete anëtare të BE-së - kanë ofruar shumicën dërrmuese të ndihmës ushtarake, financiare dhe humanitare për Ukrainën. Kjo ka qenë vendimtare në ndihmën e Ukrainës për të mbrojtur sovranitetin e saj. Ndërsa përpjekjet e udhëhequra nga SHBA-të për t'i dhënë fund luftës vazhdojnë, dhe me mjedisin e ndryshueshëm të sigurisë në ballë të mendjeve të udhëheqësve, të dy organizatat kanë treguar se mbështetja e tyre do të vazhdojë.

NATO mbështet Ukrainën përmes Ndihmës dhe Trajnimit të Sigurisë së NATO-s për Ukrainën (NSATU) - një komandë që koordinon sigurimin e pajisjeve dhe trajnimeve ushtarake për Ukrainën nga Aleatët dhe vendet partnere, Qendrës së Përbashkët të Analizës, Trajnimit dhe Edukimit (JATEC) në Poloni e cila, së bashku me Ukrainën, identifikon dhe zbaton mësimet nga lufta e Rusisë, Paketën Gjithëpërfshirëse të Ndihmës (CAP), Përfaqësimin e NATO-s në Ukrainë (NRU) dhe një numër mekanizmesh të tjerë, përfshirë Këshillin NATO-Ukrainë. Përveç mbështetjes financiare të BE-së për Ukrainën, iniciativat e BE-së, të tilla si Misioni i Ndihmës Ushtarake i BE-së, kanë trajnuar më shumë se 75,000 ushtarë ukrainas, duke bërë një ndryshim domethënës në fushën e betejës.

Zyrtarë të lartë nga Aleatët dhe partnerët mbledhen për Dialogun e parë të Sigurisë së Fqinjësisë Jugore të NATO-s

Përfaqësuesi Special i NATO-s për Fqinjësinë Jugore, Javier Colomina, thirri Dialogun e parë të Sigurisë së Fqinjësisë Jugore të Zyrtarëve të Lartë të NATO-s, i cili u mbajt në Komandën e Forcave të Përbashkëta të NATO-s në Napoli (Itali).

“Mbledhja jonë në Napoli vjen si rezultat i vendimit të marrë nga udhëheqësit aleatë në Samitin e Uashingtonit të NATO-s verën e kaluar për të miratuar një Plan Veprimi për Fqinjësinë Jugore për një qasje më të fortë, më strategjike dhe të orientuar drejt rezultateve ndaj rajonit. Po i afrohem përvjetorit të parë të miratimit të Planit; ky Dialog për Sigurinë është një pasqyrim i asaj se sa larg kemi arritur në sigurimin që fqinjësia jugore të përfshihet sistematikisht në axhendën e NATO-s”, theksoi Z. Colomina. Ai shtoi se kjo iniciativë “ofron një mundësi unike për të diskutuar situatën në zhvillim të sigurisë në rajon dhe për të shkëmbyer pikëpamje mbi prioritetet tona për bashkëpunim, me përfshirjen e drejtpërdrejtë të kryeqyteteve tona”.

Përfaqësuesi Special i NATO-s ilustroi gjithashtu zhvillimin e një Axhende të Partnerëve të Fqinjësisë Jugore NATO-Jugore

për Përbashkëpunimin e Sfidave të Sigurisë. Ky dokument u hartua në konsultim me partnerët e Dialogut Mesdhetar (MD) dhe Iniciativës së Bashkëpunimit të Stambollit (ICI) dhe u miratua nga Ministri i Jashtëm të NATO-s në takimin e tyre në Bruksel në prill. Ai identifikon fushat prioritare për dialogë tematikë, duke përfshirë perspektivat strategjike mbi sigurinë rajonale, luftën kundër terrorizmit, mbrojtjen kibernetike, sigurinë detare, luftimin e kërcënimeve të informacionit, bashkëpunimin shkencor, Armët e Vogla dhe të Lehta dhe Veprimin ndaj Minave (SALW/MA), si dhe ndryshimet klimatike dhe sigurinë.

Eventi u organizua bashkërisht nga zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Fqinjësinë Jugore dhe Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar. Në të morën pjesë rreth 90 pjesëmarrës nga Aleatët e NATO-s, vendet partnere nga Dialogu Mesdhetar i NATO-s dhe Iniciativa e Bashkëpunimit të Stambollit, si dhe organizatat rajonale.



QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT,

do të rekrutojë kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Turqisë,
8 (tetë) të drejta studimi:

- ◆ Shkolla e Lartë Ushtarake e Forcës Tokësore, 2 (dy) kuota
- ◆ Shkolla e Lartë Ushtarake e Forcës Detare, 2 (dy) kuota
- ◆ Shkolla e Lartë Ushtarake e Forcës Ajrore, 2 (dy) kuota
- ◆ Fakulteti i Mjekësisë "Gulhane", 2 (dy) kuota

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 17 korrik 2025.

Për më shumë Informacion klikoni në linkun: <https://shorturl.at/T3LZE>